

DORACAK

për promovimin e
parimeve të qeverisjes
demokratike në
këshillat e njësive të
vetëqeverisjes lokale

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

DORACAK

PËR PROMOVIMIN E PARIMEVE
TË QEVERISJES DEMOKRATIKE
NË KËSHILLAT
E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE

Publikim:	DORACAK PËR PROMOVIMIN E PARIMEVE TË QEVERISJES DEMOKRATIKE NË KËSHILLAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE
Autorë dhe autore:	Maja L Lazarova, zyrtare programatike kombëtare, departamenti i qeverisjes demokratike dhe kohezionit social, Misioni i OSBE-së në Shkup Nina Shulloviq-Cvetkovska, zyrtare programatike kombëtare, departamenti i qeverisjes demokratike dhe kohezionit social, Misioni i OSBE-së në Shkup Kristina Jovanova, zyrtare programatike kombëtare, departamenti i qeverisjes demokratike dhe kohezionit social, Misioni i OSBE-së në Shkup Ilija Stoilev, konsulent
Lektoroi:	Fatlume Adili Gongo
Dizajnoi dhe redaktoi:	Polyesterday
Tirazhi:	400

CIP - Katalogizacija во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352.075.26(497.7)(035)

ПРИРАЧНИК за промовирање на принципите на демократско управување во советите на единиците на локалната самоуправа / [автори и авторки Мaja Лазарова ... и др.]. - Скопје : ОБСЕ, 2018. - 74, 71 стр. ; 25 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Doracak për promovimin e parimeve të qeverisjes demokratike në këshillat e njësive të vetëqeverisjes lokale / autorë dhe autore Maja Lazarova ... [и др.]. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот. - Други автори: Нина Шуловиќ-Цветковска, Кристина Јованова, Илија Стоилев. - Библиографија: стр. 74

ISBN 978-608-4788-42-3

1. Лазарова, Мaja [автор] 2. Шуловиќ-Цветковска, Нина [автор] 3.

Јованова, Кристина [автор] 4. Стоилев, Илија [автор]

а) Локална самоуправа - Општински советници - Права и надлежности

- Македонија - Прирачници COBISS.MK-ID 109253386

Поддржано од:



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
I. DECENTRALIZIMI	7
I.1. Decentralizimi si proces	7
I.2. Kompetencat e organeve komunale	10
I.3. Të drejtat themelore dhe përgjegjësitë e Këshillit	11
I.4. Organizimi territorial i njësive të vetëqeverisjes lokale	16
I.5. Burimet e financimit të vetëqeverisjes lokale	19
II. MBIKËQYRJA E PUNËS SË KOMUNAVE	21
II.1. Llojet e mbikëqyrjes	22
II.2. Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e dispozitave të komunave	23
II.3. Aspektet kushtetuese-juridike të mbikëqyrjes	25
III. PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE QYTETAREVE NË VENDIMMARRJEN NË NIVEL LOKAL	26
III.1. Baza juridike për pjesëmarrjen qytetare në vend	27
III.2. Mënyra të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve	28
III.3. Elementet e duhura për pjesëmarrje qytetare efektive	31
III.4. Pengesa për pjesëmarrjen qytetare	32
IV. TRANSPARENCA NË PUNË NË NIVEL LOKAL	34
IV.1. Zbatimi i PARIMEVE të transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunalë	36
IV.2. Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunalë	37

V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL	41
V.1 Korniza ligjore për bashkëpunim ndërkomunal	41
V.2 Modelet e ndryshme të bashkëpunimit ndërkomunal	42
V.3. Përfitimet nga themelimi dhe funksionimi i bashkëpunimit ndërkomunal	44
V.4 Përvojat e deritanishme nga bashkëpunimi ndërkomunal në vend	45
VI. KOMISIONET PËR MARRËDHËNIET MES BASHKËSIVE	48
VI.1. Përbërja etnike e popullsisë në njësitë e vetëqeverisjes lokale	48
VI.2. Mënyra e formimit të komisioneve për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive	50
VI.3. Funksionimi i komisioneve për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive	51
VII. FORMAT E VETËQEVERISJES LOKALE	53
VII.1. Statusi juridik dhe format e vetëqeverisjes lokale	53
VII.2. Themelimi dhe parakushtet për funksionimin e bashkësive vetëqeverisëse	54
VIII. BARAZIA GJINORE NË NIVEL LOKAL	56
VIII.1. Korniza juridike për barazinë gjinore	57
VIII.2. Përfshirja e perspektivës gjinore (gender mainstreaming) në punën e njësive të vetëqeverisjes lokale	58
VIII.3. Mekanizma dhe masa për avancimin barazisë gjinore në nivel lokal	60
IX. ETIKA DHE INTEGRITETI NË NIVEL LOKAL	62
IX.1. Korniza ligjore për modelin e integritetit të përfaqësuesve dhe përfaqësuesve të zgjedhur/a	62
IX.2. Mënyrat për përforcimin e integritetit të funksionarëve lokalë	64

HYRJE

Ky doracak u dedikohet anëtarëve dhe anëtareve të këshillave komunalë në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) të vendit dhe ka qëllim që përfaqësuesve dhe përfaqësueseve të zgjedhura të qeverisë lokale t'u sigurojë informata të domosdoshme për punën, në përputhje me parimet e qeverisjes demokratike, reformën për decentralizim, kompetencat e organeve komunale dhe mbikëqyrjen e punës së njërive të vetëqeverisjes lokale. Qëllimi parësor është që anëtarët dhe anëtares të këshillave komunalë t'i kuptojnë bazat e funksionimit të mirë të Këshillit si organ komunal për përforcimin e demokracisë në nivel lokal, përmes respektimit të plotë të dispozitave ligjore dhe përforcimit të etikës, integritetit dhe mirëbesimit të qytetarëve dhe qytetareve në organet komunale.

Që nga fillimi i procesit të decentralizimit në vitin 2005, organizata të shumta kanë realizuar programe për ndërtimin e kapaciteteve të organeve komunale. Pas zgjedhjeve të fundit lokale në vitin 2017, u etabluan përbërjet e reja të këshillave komunalë dhe funksionin anëtar/anëtare këshilli e morën përsipër gjithsej 1347 përfaqësues dhe përfaqësuese të zgjedhur/a në të gjitha 81 njësitë e vetëqeverisjes lokale. Numri më i madh i tyre funksionin e këshilltarit e kryejnë për herë të parë. Misioni i OSBE-së në Shkup gjatë gjithë kësaj periudhe realizon programe për përkrahjen e përfaqësuesve dhe përfaqësueseve të zgjedhur/a në këshillat komunalë.

Për funksionimin e drejtë të Këshillit, si organ "ligjdhënës" në nivel lokal i cili udhëheq politikën dhe miraton aktet ligjore në komunë, me rëndësi jetike është që të gjithë anëtarët dhe anëtares të tij të kenë njohuri substanciale lidhur me të drejtat dhe kompetencat ligjore që kanë si përfaqësues/e të zgjedhur/a. Rrjedhimisht, konsiderojmë se ky doracak do ta lehtësojë në masë të madhe akumulimin e njohurive të nevojshme të anëtarëve dhe anëtareve të këshillave komunalë dhe do të zgjidhë disa nga dilemat me të cilat ballafaqohen ata/ato lidhur me punën ligjore. Shpresojmë se përdorimi i doracakut do të kontribuojë për një efikasitet, efektivitet, transparencë dhe mbikëqyrje sa më të madhe në kryerjen e funksionit këshilltar/e në nivel lokal. Doracak u jep mundësinë për përsiatje, përkatësisht hap horizontin

për veprim të mëtëjshëm dhe për krijimin e një vullneti sa më të madh politik nga përfaqësuesit dhe përfaqësueset e përzgjedhur/a në nivel lokal, në drejtim të zhvillimit të demokracisë lokale.

Përmbajtja e doracakut është plotësisht e harmonizuar me aktet ligjore dhe ndryshimet e fundit në drejtim të zhvillimit dhe ndjekjes së procesit të decentralizimit, me theks të veçantë në punën e këshillave komunalë.

Për ta përmbyllur këtë pjesë hyrëse, por duke mos e konsideruar më pak të vlefshme, duam ta theksojmë faktin se përmes këtij doracaku duam të kontribuojmë edhe në avancimin e barazisë gjinore në nivel lokal dhe ta nxisim përdorimin e gjuhës me theks gjinor. Meqë në literaturën dhe legjislaturën vendase emrat e përgjithshëm që përcaktojnë profesione, tituj e të ngjashëm përdoren në gjini mashkullore duke nënkuptuar të dyja gjinitë, në këtë doracak ndryshuam këtë qasje, duke përdorur të dyja format gramatikore në mënyrë të barabartë, gjininë mashkullore dhe femërore. Përjashtim është bërë vetëm në formulimet që janë marrë si burimore nga ligjet përkatëse ose që janë cituar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

I. DECENTRALIZIMI

I.1. Decentralizimi si proces

Në dy dekadat e fundit në vendin tonë decentralizimi i pushtetit është në fokusin e jetës politike dhe administrative. Në vitin 1999 Qeveria miratoi Strategjinë për reforma të vetëqeverisjes lokale. Realizimi i suksesshëm i reformës për vetëqeverisje lokale, duke përfshirë edhe decentralizimin, është detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në (2001) dhe nga Vendimi i Komisionit Evropian për fillimin e procesit të negociatave për anëtarësim në BE. Në vitin 1997 vendi ynë nënshkroi Kartën për Vetëqeverisje Lokale të Këshillit të Evropës, e në vitin 2013 protokollin drejt Kartës, që u ratifikua në vitin 2015 dhe hyri në fuqi në vitin 2016. Me këtë vendi detyrohet t'u mundësojë komunave pavarësi financiare dhe burime vetanake të garantuara të të ardhurave, si dhe pjesëmarrje në të ardhurat nga tatimet që i mbledh pushteti qendror.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e nënshkruar në vitin 2001 dhe amandamentet e Kushtetutës nga nëntori i vitit 2001, nxitën reformën e vetëqeverisjes lokale. Si rezultat i kësaj, në janar të vitit 2002 u miratua ligji i ri për vetëqeverisjen lokale. Në vitin 2003 Qeveria miratoi Programin Operativ për Decentralizim, që përmban listë ligjesh që kanë të bëjnë nga afër me decentralizimin. Kësaj liste, përveç ligjeve kyçe sistimore (ligji për organizimin territorial, ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, ligji për Qytetin e Shkupit) iu shtua edhe një numër i madh i ligjeve plotësuese (mbi 80), që rregullojnë transferimin faktik të kompetencave dhe resurseve, sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Sipas ligjit dhe Kushtetutës, të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të pavarura në kryerjen e kompetencave të tyre, ndërsa kontrolli i ligjshmërisë së punës së tyre është kompetencë e pushtetit qendror. Më 1 korrik 2005 njësitë e vetëqeverisjes lokale filluan me ushtrimin e kompetencave të reja në kushte organizimi të ri territorial të vetëqeverisjes lokale, me përfaqësues të sapozgjedhur të qeverisë lokale dhe me mënyrën e re të financimit të njësive të vetëqeverisjes lokale, të ashtuquajturin decentralizim fiskal. E gjithë kjo zhvillohej në dy faza, për shkak të

ndërtimit gradual të kapaciteteve fiskale dhe administrative të njësive të vetëqeverisjes lokale në vend.

Cilat janë qëllimet kryesore të procesit të decentralizimit?

Decentralizimi i pushtetit është transferimi i një pjese të kompetencave të pushtetit qendror në nivel lokal – komunave dhe Qytetit të Shkupit, ky i fundit si njësi e veçantë me 10 komuna në përbërjen e vet. Me decentralizimin e pushtetit, një numri të madh çështjesh që kanë rëndësi esenciale për qytetarët dhe qytetaret iu dha kuptim lokal. Reforma e vetëqeverisjes lokale ka qëllim të sigurojë demokraci lokale, stabilitet, shërbime më cilësore publike dhe zhvillim lokal ekonomik. Rrjedhimisht, decentralizimi si proces duhet të kontribuojë në këto mënyra:

- Duke e bërë më të afërt për qytetarët dhe qytetaret fuqinë për vendimmarrje;
- Duke përforcuar institucionet demokratike në nivel lokal;
- Sundimi i ligjit – niveli më i lartë i respektimit të ligjeve;
- Duke siguruar shërbime më cilësore publike në nivel lokal;
- Me mekanizma kontrolli që do të garantojnë transparencë dhe trajtim të barabartë të qytetarëve dhe qytetareve në shfrytëzimin e shërbimeve publike.

Decentralizimi i pushtetit është transferimi i një pjese të kompetencave të pushtetit qendror në nivel lokal

Edhe pse ka kornizë ligjore, realizimi i procesit të decentralizimit vijon ende dhe një pjesë e madhe e komunave ballafaqohen me sfida të ndryshme, si rezultat i kompleksitetit të këtij procesi dhe modelit monotipik të decentralizimit (kompetenca të njëjta për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale). Reforma e vetëqeverisjes lokale duhet ta përforcojë kapacitetin fiskal të njësive të vetëqeverisjes lokale, mundësitë për punësim, krijimin e një administrate më kompetente, më transparente dhe më të përgjegjshme, sigurimin e instrumenteve përmes të cilave qytetarët dhe qytetaret do të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes për çështje me rëndësi lokale; ato do të bëhen partnerë të pushtetit qendror dhe do të përgatiten në nivel lokal për integrimet në BE. Anëtarët dhe anëtarët e këshillave duhet t'i kenë parasysh të gjitha këto aspekte gjatë procesit të vendimmarrjes.

Në kuadër të kompetencave të veta, Këshilli i Komunës miraton aktet e përgjithshme në vijim:

- Statutin
- Rregulloren e punës
- Programet dhe planet
- Vendimet
- Dispozitat tjera, të parapara me ligj.

Me **statutin** e komunës, si akt më i lartë juridik në këtë nivel, përcaktohen këto aspekte: organizimi dhe puna e organeve të komunës; organizimi dhe puna e komisioneve të Këshillit; kryerja e punëve me interes publik me rëndësi lokale, që nuk janë hequr nga kompetencat e saj, e që nuk janë kompetenca të organeve të pushtetit qendror; mënyra e informimit të qytetarëve dhe qytetareve; rrethanat kur ata përjashtohen nga seancat e Këshillit; mënyra dhe procedura e dorëzimit të parashtrësive dhe propozimeve për punën e organeve të komunës, si dhe shqyrtimi i tyre; mënyra e organizimit të tribunave publike; anketimi dhe mbledhja e propozimeve nga qytetarët; mënyra e kryerjes së detyrimeve nga sfera e mbrojtjes në gjendje lufte; dhe çështje të tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Me **programet dhe planet** përcaktohen dhe shtjellohen çështje të caktuara për zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera, me të cilat janë transferuar kompetencat e komunës, e për të cilat duhet të parashihen afate dhe dinamika zbatimi (për shembull: programi për higjienën komunale, programi për furnizimin me ujë etj).

Rekomandime

Çdo anëtar/anëtare këshilli, në fillim të mandatit duhet të pranojë kopje të statutit aktual të komunës, për t'u njohur së afërmi me përmbajtjen e tij.

Po ashtu preferohet që këshillat t'i shkëmbejnë mes vete buletinet zyrtare, për t'u njohur me përvojat e komunave tjera në vend, që do të mundësonte përputhje më të madhe mes vendimeve dhe dispozitave ligjore.

1.2. Kompetencat e organeve komunale

Ligji për vetëqeverisjen lokale përcakton kompetencat e organeve të komunës – Këshillit dhe kryetarit/kryetares të komunës. Këto kompetenca jepen në tabelën më poshtë.

KËSHILLI	KRYETARI/KRYETARJA
<ol style="list-style-type: none"> 1. Miraton statutin dhe aktet e tjera të komunës; 2. Miraton buxhetin dhe bilancin vjetor të komunës; 3. Përcakton shumën e burimeve të të ardhurave vetanake për financimin e komunës, siç parashihet me ligj; 4. Themelon ndërmarrje publike në kuadër të kompetencave të komunës dhe mbikëqyr punën e tyre; 5. Emëron anëtarë/anëtare në këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike të cilat i themelon; 6. Miraton programe pune dhe plane financiare për financimin e ndërmarrjeve publike të cilat i ka themeluar komuna; 7. Miraton raportet për realizimin e buxhetit dhe bilancin vjetor të komunës; 8. Vendos për dhënie leje për veprimtari me interes publik të rëndësive lokale, në pajtim me ligjin; 9. Miraton raportet për punën dhe bilancet vjetore të ndërmarrjeve publike, të cilat i ka themeluar komuna; 10. Vendos për mënyrën e shfrytëzimit të pronës së komunës; 11. Vendos për mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës, në pajtim me ligjin; 12. Zgjedh personin që do të udhëheqë me njësinë rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendshme në komunë, në pajtim me ligjin; 13. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor për siguri publike në qarkun e komunës, të cilin ia dorëzon ministrit/ministres së Punëve të Brendshme dhe Avokatit/Avokates të/së Popullit; 14. Personit udhëheqës të njësisë rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendshme mund t'i japë propozime nga sfera e sigurisë publike dhe sigurisë në trafik. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. E përfaqëson komunën; 2. Kontrollon ligjshmërinë e rregulloreve të Këshillit; 3. Shpall aktet e Këshillit në buletin zyrtar të komunës; 4. Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit; 5. Siguron realizimin e punëve që me ligj i janë deleguar komunës; 6. Inicon dhe propozon miratimin e rregulloreve nën kompetencat e Këshillit; 7. Propozon buxhetin vjetor dhe bilancin vjetor të buxhetit të komunës; 8. Realizon buxhetin e komunës; 9. Me konkurs publik zgjedh drejtorë/drejtores të ndërmarrjeve publike të cilat i ka themeluar komuna; 10. Në mënyrë të rregullt informon Këshillin për kryerjen e detyrave të veta sipas statutit; 11. Në këshilla drejtues vendos për të drejta, përgjegjësi dhe interesa të subjekteve juridike dhe personave fizikë, sipas ligjit; 12. Miraton rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale; 13. Udhëheq administratën komunale; 14. Këshillit ia dorëzon planin për punësime vjetore dhe, pas miratimit, ia dërgon Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe administratës komunale; 15. Vendos për punësimet, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale, përveç nëse me ligj nuk është e paraparë ndryshe; 16. Mundëson shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e drejtë dhe ligjore të pronës së komunës, sipas ligjit dhe statutit.

I.3. Të drejtat themelore dhe përgjegjësitë e Këshillit

Planifikimi urbanistik (urban dhe rural)

Anëtarët dhe anëtares e Këshillit, në sferën e planifikimit urbanistik së pari duhet të njihen me llojet e planeve urbanistike:

- Plani urbanistik i përgjithshëm;
- Plani urbanistik i detaluar;
- Plani urbanistik për fshatin;
- Plani urbanistik jashtë vendbanimeve.

Këshilli i Komunës, përmes organeve të veta, merr pjesë vazhdimisht në miratimin e planeve urbanistike. Anëtarët dhe anëtares e Këshillit i miratojnë planet urbanistike me vendim i cili është pjesë përbërëse e planit të miratuar. Përpilimi i planeve urbanistike bëhet në dy faza, njëherë si skicë plani dhe pastaj si propozim-plan. Për përpilimin e planeve urbanistike të komunës dhe Qytetit të Shkupit, Këshilli i Komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit miratojnë program vjetor. Këshilli i Komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit miratojnë planet urbanistike. Karakteristike për Qytetin e Shkupit është fakti që Këshilli i Qytetit të Shkupit miraton vetëm planin urbanistik të përgjithshëm. Komunitat miratojnë planin urbanistik të detaluar, planin urbanistik për fshatin dhe planin urbanistik jashtë vendbanimeve.

Veprimtaritë komunale

Veprimtaritë komunale kryhen në bazë të planeve dhe programeve zhvillimore, që miratohen nga Këshilli i Komunës, këshilli i komunave të Qytetit të Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit për periudhë trevjeçare. Detyrë e secilës komunë është të sigurojë kushte për realizimin e organizuar dhe të vazhdueshëm të veprimtarive komunale dhe zhvillimin e tyre, e sidomos për sigurimin e:

- kushteve materiale, teknike dhe kushteve të tjera për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e objekteve të infrastrukturës komunale, si dhe unifikimin teknik-teknologjik të sistemit për realizimin e përhershëm dhe të vazhdueshëm të veprimtarive komunale;
- cilësisë dhe vëllimit të duhur të shërbimeve komunale, varësisht nga mundësitë materiale të komunës;
- kontrollit mbi subjektet juridike dhe personat fizikë, të cilët kryejnë veprimtari komunale përkatëse.

Nëse komuna nuk ka themeluar ndërmarrje publike, realizimin e veprimtarive komunale mund t'ua besojë subjekteve juridike dhe personave fizikë që kanë leje për kryerjen e veprimtarisë përkatëse, sipas kushteve të parapara me ligj, me të cilat rregullohet veprimtaria komunale e caktuar. Me ligj përcaktohet edhe e drejta që dhënës i shërbimeve komunale të jetë ndërmarrje publike e themeluar nga komuna, komunat e qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, Qeveria ose subjekti juridik dhe personi fizik që ka leje për kryerjen e veprimtarisë komunale.

Këshilli i Komunës miraton program vjetor për ndërtimin, rikonstruktimin dhe rehabilitimin e rrugëve komunale. Po ashtu, Këshilli i Komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit, me propozim të kryetarit/kryetares përcaktojnë kushtet, mënyrën dhe trajtat e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale. Këshilli i Komunës sjell vendim me të cilin rregullohet mirëmbajtja e pastërtisë së hapësirave publike, mënyra e shfrytëzimit të hapësirave publike dhe mbledhja e mbeturinave, pastrimi i borës dhe akullit, mënjanimi i sendeve që rrezikojnë pastërtinë publike, si dhe masat për zbatimin e vendimit. Me vendim të Këshillit, punët për mirëmbajtjen e pastërtisë publike komuna mund t'ia ndajë për realizim një subjekti juridik, i regjistruar për kryerjen e këtyre punëve, sipas ligjit. Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimeve është veprimtari me interes publik në sferën komunale në territorin e komunës dhe kjo realizohet përmes realizimit të programit, të cilin në fund të vitit, për vitin e ardhshëm, e miraton Këshilli i Komunës.

Ndërtimi, mirëmbajtja dhe pastrimi i shtretërve të lumenjve realizohet në bazë të programit që miraton Këshilli i Komunës, me të cilin parashihen mjetet e nevojshme dhe mekanizimi ndërtimor përkatës që është në dispozicion, ose me angazhimin e palëve të treta.

Arsimi

Sipas ligjit, themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme në bashkëpunim me pushtetin qendror është kompetencë e njësisive të vetëqeverisjes lokale, ashtu si dhe organizimi i transportit dhe ushqimit të nxënësve dhe vendosja e tyre në konvikte.

Këshilli i Komunës miraton vendimin për themelimin e një shkolle fillore ose të mesme, pasi të ketë marrë paraprakisht mendim nga Qeveria. Secila komunë për rajonin e vet ka regjistër të shkollave fillore dhe të mesme. Këshilli i Komunës dorëzon propozim-planin për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme komunale për vitin e ardhshëm shkollor, e pastaj Ministria shpall konkurs për gjitha shkollat e mesme, më së voni deri më 31 mars.

Arsimi financohet nga transferta shtetërore, të ashtuquajtura dotacione në bllok. Mjetet e marra nga dotacionet në bllok ose dotacionet e dedikuara komuna ua shpërndan shkollave në qarkun e vet, sipas masave dhe kritereve që i përcakton Këshilli i Komunës. Komunitat kanë të drejtë nga burime të veta të planifikojnë mjete plotësuese dhe t'i dedikojnë për arsimin. Të dhënat nga plani vjetor financiar dhe bilanci vjetor të shkollave fillore dhe të mesme komuna i publikon në "Buletin Zyrar" të komunës. Këshilli i Komunës emëron dy përfaqësues/përfaqësuese në këshillin e shkollës të shkollave fillore dhe të mesme, me mandat trevjeçar.

Puna dhe politika sociale

Kompetencat e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve janë të transferuara shumë pak në nivel lokal. Këto aktivitete kryesisht udhëhiqen nga institucionet qendrore, përkatësisht nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, me përjashtim të udhëheqjes dhe mirëmbajtjes së kopshteve të fëmijëve, pushimoreve për fëmijë dhe, në disa komuna, edhe azileve të pleqve.

Këshilli i Komunës, në qarkun e së cilës gjendet selia e qendrës për punë sociale, propozon një anëtar/anëtare nga radhët e shërbimeve profesionale të qendrës për punë sociale. Komunitat, Qyteti i Shkupit dhe komunitat e Qytetit të Shkupit nuk kanë kompetenca të decentralizuara në sferën e mbrojtjes sociale.

Kopshti publik i fëmijëve themelohet nga Këshilli i Komunës, Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe Qeveria, me vendim për themelimin e kopshteve publike, pas marrjes paraprake të mendimit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Kryetari/kryetarja i/e komunës zgjedh dhe shkarkon nga detyra drejtorin/drejtoreshen e kopshtit publik.

Pëlqimin për statutin e kopshtit publik, të themeluar nga komuna, Qyteti i Shkupit apo komunitat e Qytetit të Shkupit, e jep Këshilli i Komunës dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Kultura

Komunitat udhëheqin institucionet nga sfera e kulturës, përkatësisht shtëpitë e kulturës, bibliotekat, një pjesë të muzeve, një pjesë të teatrove dhe institucione të tjera. Këshilli i Komunës, Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe këshillat e komunave të Qytetit të Shkupit përzgjedhin anëtarët/anëtareshet e këshillit drejtues të institucionit i cili ka 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë

emra eminentë nga sfera e kulturës dhe dy përfaqësues/përfaqësuese nga të punësuarit në institucion.

Këshilli i Komunës, përkatësisht Qyteti i Shkupit dhe komunat e Qytetit të Shkupit miratojnë program pesëvjeçar për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personave të dalluar në rrafsh lokal. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale me më shumë komunitete, ky program miratohet në Këshillin e Komunës me të ashtuquajturin model-parim vendimmarrjeje “Badenter”. Propozime për vendosjen dhe shënimin e monumenteve-përmendoreve Këshillit të Komunës mund t’i japin: qytetarët dhe qytetaret, subjektet juridike, shoqatat qytetare, fondacionet dhe të tjerë, e po këta mund të marrin pjesë edhe në financimin e këtyre përmendoreve.

Mbrojtja nga zjarri

Me ligjin për mbrojtje nga zjarri, njësitë zjarrfikëse ekzistuese (objektet, pajisjet etj.) janë nën kompetenca të njësive të vetëqeverisjes lokale. Në komunat më të mëdha janë formuar njësi territoriale, por këto mbulojnë edhe rajonin më të gjerë, përkatësisht i përfshijnë edhe komunat ku nuk ka njësi territoriale zjarrfikëse. Komunat që nuk kanë njësi territoriale zjarrfikëse participojnë financiarisht për të mundësuar funksionimin e tyre.

Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës

Me “mbrojtje të mjedisit jetësor” nënkuptohet marrja e masave për mbrojtjen dhe parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës, si dhe mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurma dhe rrezatimi jonizues. Komunat në vendin tonë kanë për detyrë të miratojnë dhe realizojnë planin lokal ekologjik të aksionit, sipas planit kombëtar ekologjik të aksionit për periudhë gjashtëvjeçare. Këshillat e komunave, Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe këshillat e komunave të Qytetit të Shkupit duhet të themelojnë organ që do të udhëhiqet nga kryetari/kryetareja i/e komunës, i cili do ta ndjekë implementimin e planit lokal të aksionit për mjedisin jetësor dhe për këtë, një herë në vit do ta informojë organin e administratës shtetërore, përgjegjës për fushën e mjedisit jetësor.

Këshilli i Komunës, më propozim të kryetarit/kryetares të/së komunës miraton edhe programin për menaxhimin e mbeturinave. Kryetari/kryetarja e komunës ka detyrë çdo vit t’i dorëzojë raport Ministrisë për realizimin e programeve të veta për menaxhimin e mbeturinave. Raporti për vitin paraprak dorëzohet deri më 28 shkurt të vitit aktual. Kriteret specifike për trajtimin e mbeturinave komunale dhe llojeve të tjera të mbeturinave të

parrezikshme në territorin e komunës i përcakton Këshilli, me propozim të kryetarit/kryetares.

Veprimtarinë e mbledhjes dhe/ose transportit të mbeturinave komunale dhe llojeve të tjera të mbeturinave të parrezikshme mund ta bëjnë ndërmarrje publike të themeluara nga një apo më shumë komuna (bashkëpunim ndërkomunal) dhe subjekte juridike dhe persona fizikë që kanë marrëveshje me komunën, sipas procedurës për tenderim publik ose sipas dispozitave të ligjit për koncesionet.

Këshilli i Komunës ose Këshilli i Qytetit të Shkupit miraton programin për zvogëlimin e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit të ambientit. Këshillat e komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit miratojnë planet e aksionit për mbrojtjen e ajrit të ambientit.

Zhvillimi ekonomik lokal

Inkurajimi i zhvillimit ekonomik lokal duhet të jetë proces participues ku të gjithë palët i kushtojnë rëndësi krijimit të kushteve të volitshme për prosperitet ekonomik në territorin e komunës. Zhvillimi ekonomik lokal (ZHEL) është proces ku palët pjesëmarrëse nga sektori publik, sektori privat (afarist) dhe nga sektori joqeveritar punojnë bashkërisht dhe krijojnë kushte të volitshme për hapjen e bizneseve të reja, hapjen e vendeve të reja të punës në njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve. Në vendin tonë mekanizma më të aplikuar për ZHEL janë:

- Sondazhet për klima afariste;
- Profili i bashkësisë (komunës);
- Hulumtimi i opinionit publik;
- Studimi për arsyeshmërinë ekonomik.

Këshilli dhe kryetari/kryetarja duhet të veprojnë bashkërisht për shfrytëzimin maksimal të potencialeve materiale dhe njerëzore me të cilat disponon komuna në të gjithë territorin e vet. Po ashtu duhet të merren parasysh edhe potencialet e komunave fqinje dhe përmes ndërveprimit të përbashkët të arrihen rezultate më të mira në fushën e promovimit të zhvillimit ekonomik lokal.

Mbrojtja dhe shpëtimi

Aktiviteti më i rëndësishëm nga kjo fushë nën kompetencat e Këshillit të Komunës, i cili ka për detyrë të përpilojë program vjetor për mbrojtje dhe shpëtim, është definimi i përgjegjësive të ndërmarrjeve, enteve dhe shërbimeve publike, në rast nevojë për mbrojtje dhe shpëtim; përcaktimi i shumës së mjeteve buxhetore të komunës për aktivitete nga sfera e mbrojtjes dhe shpëtimit; marrja e vendimeve për shpërndarjen e ndihmës humanitare për popullatën e prekur etj.

Mbrojtja sociale


Me procesin e decentralizimit, kopshtet e fëmijëve, pushimoret e fëmijëve dhe qendrat për punë sociale janë nën kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale, të cilat marrin pjesë në punën e këtyre subjekteve përmes përfaqësuesve/përfaqësueseve të vet/a në bordet drejtuese. Bordet drejtuese të kopshteve për fëmijë përbëhen nga pesë anëtarë/anëtare, një prej të cilëve propozohet nga këshillat e NJVL-së. Këshilli është kompetent të japë pëlqim për statutin e punës së kopshteve të themeluara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Kopshti publik i fëmijëve themelohet nga Këshilli i Komunës, pas marrjes paraprake të mendimit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Financimi i kësaj kompetence të NJVL-së bëhet përmes dotacioneve në bllok nga buxheti shtetëror.

1.4. Organizimi territorial i njësive të vetëqeverisjes lokale

Sipas ligjit për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale, në vendin tonë ka gjithsej 81 njësi të vetëqeverisjes lokale, prej të cilave 30 komuna me seli në qytet, 40 komuna me seli në fshat, 10 komuna në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Komuna më e madhe në vend sipas numrit të banorëve është komuna e Kumanovës me 105,484 banorë, ndërsa më e vogla ajo e Vevçanit me 2,433 banorë. Sipas territorit, komuna më e madhe është ajo e Prilepit me 1,198 km², ndërsa më e vogla komuna e Vevçanit me 23 km². Këta tregues pasqyrojnë qartë faktin se NJVL-të janë heterogjene dhe se ekzistojnë dallime të mëdha mes tyre dhe kjo rrjedhimisht përcakton edhe rritjen, zhvillimet dhe kapacitetet.

Sipas organizimit të tashëm territorial të NJVL-ve në vend, parë nga aspekti i strukturës së popullatës, numri më i madh i komunave ka nga 10,000 në 20,000 banorë, e gati 76% të komunave kanë deri 40,000 banorë. Struktura e komunave sipas numrit të banorëve jepet në tabelën më poshtë.



Burimi: Regjistrimi i popullsisë, 2002

Ekzistojnë dallime të rëndësishme në numrin dhe dendësinë e popullsisë edhe nga aspekti i rajoneve planifikuese, të cilat janë të përcaktuara në bazë të ligjit për zhvillimin rajonal të barabartë. Sipas numrit të banorëve, rajoni planifikues verilindor ka më pak banorë, ndërsa më i populluar është rajoni planifikues i Pollogut. Dallimet demografike janë faktorë determinues për potencialet për zhvillimin e rajoneve të caktuara planifikuese, të lidhura ngushtë me faktorë të tjerë për rritje dhe zhvillim. Treguesit për rajonet planifikuese jepen në tabelën në vijim.

Të dhëna bazë për rajonet planifikuese

	Numri i NJVL-ve	Numri i vendbanimeve	Banorë Regjistrimi 2002	Sipërfaqja në km ²	Dendësia e popullsisë / banorë në km ²
Në gjithë vendin	81	1.767	2,022,547	25.713	78,6
i Pellagonisë	9	343	238.136	4.717	49,4
i Vardarit	9	171	133.248	4.042	38,0
verilindor	6	192	172.787	2.310	74,9
jugperëndimor	9	286	221.651	3.340	67,0
i Shkupit	17	142	571.040	1.812	318,0
juglindor	10	188	175.442	2.739	62,5
i Pollogut	9	184	304.125	2.416	123,4
lindor	11	261	181.858	3.537	48,5

Burimi: Ligji për zhvillimin rajonal të barabartë, 2007

Nga numri i banorëve/banoreve në një komunë varet edhe numri i anëtarëve dhe anëtareve në Këshillin e Komunës. Raporti mes numrit të banorëve/banoreve dhe numrit të këshilltarëve/këshilltareve në komuna jepet në tabelën më poshtë:

Madhësia e këshillave komunalë

Numri i banorëve	Numri i banorëve	Numri i anëtarëve dhe anëtareve të këshillit
	Deri 5.000	9
Nga 5.001	Deri 10.000	11
Nga 10.001	Deri 20.000	15
Nga 20.001	Deri 40.000	19
Nga 40.001	Deri 60.000	23
Nga 60.001	Deri 80.000	27
Nga 80.001	Deri 100.000	31
	Mbi 100.000	33

Burimi: Ligji për vetëqeverisjen lokale, 2002

Nga organizimi aktual territorial të NJVL-ve u vendosën kufij gjeografikë të rinj në pjesën më të madhe të komunave, që kontribuoi për krijimin e strukturës së re demografike, etnike, politike dhe ekonomike në kuadër

të vetë NJVL-ve. Rrjedhimisht, gjatë gjithë këtyre viteve që nga fillimi i decentralizimit, NJVL-të duhej ta përshtatnin funksionimin e tyre dhe të gjenin mënyra për të plotësuar në mënyrë më efikase dhe më efektive nevojat e qytetarëve për shërbime publike lokale.

1.5. Burimet e financimit të vetëqeverisjes lokale

Decentralizimi fiskal është proces i veçantë në kuadër të reformës për decentralizimin. Decentralizimi fiskal është proces gjatë të cilit pushteti qendror duhet të sigurojë mjete financiare përkatëse dhe të mjaftueshme, si dhe t'i japë autorizime të caktuara buxhetore pushtetit lokal, në mënyrë që NJVL-të të marrin vendime në mënyrë të pavarur në lidhje me mbledhjen dhe shpenzimin e mjeteve financiare për të cilat janë autorizuar. Procesi i decentralizimit nuk do t'i japë rezultatet e pritura pa pasur një sistem të duhur të autorizimeve financiare për komunat. Komunat e kanë të domosdoshme të kenë mjete financiare të mjaftueshme për të siguruar cilësi adekuate të shërbimeve publike. Korniza themelore për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale përcaktohet me ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes Lokale. Sipas dispozitave të këtij ligji, komunat financohen nga këto tri burime të mëdha financimi:

A. Burime financimi që vijnë nga vetë komuna

- tatimet lokale,
- kompensimet që i paguhen komunës dhe
- tatimet lokale të parapara me ligj.
- burime tjera nga vetë komuna (dënimet lokale, vetëkontributi, të hyrat e pronës etj.)

Këshilli i Komunës përcakton shumën e normave tatimore dhe shumën e kompensimeve dhe tatimeve në korniza të parapara me ligj.

B. Transferta dhe dotacione nga pushteti qendror

- Të hyra nga tatimi i vlerës së shtuar
- Dotacionelo të dedikuara
- Dotacione në bllok
- Dotacione kapitale
- Dotacione për kompetenca të deleguara

C. Huamarrje

- Huazim dhe huamarrje
- Dhënie e letrave komunale me vlerë

Këshilli i Komunës duhet ta miratojë huazimin afatgjatë, në bazë të debatit paraparak publik lidhur me këtë çështje.

Rekomandim

Anëtarët e Këshillit, përmes vendimeve që sjellin lidhur me financimin, luajnë rolin e financuesit të vetëqeverisjes lokale. Këshilltarët kanë të drejtë dhe detyrë të ndjekin gjendjen financiare në komunë, të ndjekin realizimin e buxhetit, të kërkojnë informata për gjendjen e pagesave të burimeve të të ardhurave që vijnë nga vetë komuna, të marrin pjesë në përcaktimin e prioriteteve lokale për financimin e planeve zhvillimore të komunës dhe t'i shqyrtojnë e t'i miratojnë raportet periodike dhe vjetore të komunës dhe shfrytëzuesve buxhetorë lokalë (ndërmarrjet publike dhe institucionet e tjera nën kompetencat e pushtetit lokal).

II. MBIKËQYRJA E PUNËS SË KOMUNAVE

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së njërive të vetëqeverisjes lokale dhe kontrolli mbi funksionimin material-financiar kanë të bëjnë me zbatimin e parimit të sundimit të ligjit dhe respektimit të ligjeve në vendin tonë, në fushën e vetëqeverisjes lokale. Procesi i decentralizimit nuk nënkupton vetëm të drejta më të mëdha, por edhe përgjegjësi më të madhe të pushtetit lokal ndaj qytetarëve dhe qytetareve. Kryetari/kryetarja dhe Këshilli i Komunës – kanë të drejtë dhe detyrim t'i përdorin resurset lokale në interes sa më të mirë të pjesës më të madhe të qytetarëve dhe qytetareve dhe në përputhje me prioritetet e përcaktuara, me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve përmes procesit konsultativ.

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së njërive të vetëqeverisjes lokale dhe kontrolli mbi funksionimin material-financiar kanë të bëjnë me zbatimin e parimit të sundimit të ligjit

Pse është e nevojshme mbikëqyrja e punës së pushteteve lokale?

1. Transfermii i një mase të madhe të kompetencave në nivel lokal nënkupton përgjegjësi më të madhe të pushtetit lokal ndaj qytetarëve dhe qytetareve;
2. Zbatimi i kompetencave nga pushteti lokal duhet të jetë komplementare, pra në pajtueshmëri me prioritetet kombëtare për përmbushjen sa më cilësore të nevojave publike dhe për respektimin e të drejtave të qytetarëve dhe qytetareve;
3. Në punën e pushtetit lokal duhet të sigurohet respektimi i ligjeve, respektimi i procedurave të parapara dhe ligjshmëria e kushtetutshmëria gjatë miratimit të dispozitave dhe akteve.

Sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale, komuna mund të organizojë inspektoratin komunal për realizimin e mbikëqyrjes inspektuese në kryerjen e punëve nën kompetencat e saj, ndërsa organizimin, fushëveprimin dhe

mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale e përcakton Këshilli, me propozimin e kryetarit/kryetares. Përveç kësaj, ligji nuk i parasheh në mënyrë precize fushat në të cilat komunat mund të organizojnë inspektorate komunale. Nuk ekziston as rregullativë ligjore më e saktë që do bënte unifikimin e praktikave lidhur me pyetjen për pasojat juridike në rast se komuna, edhe krahas mundësisë ligjore, nuk emëron inspektor/inspektore. Disa nga ligjet materiale parashohin që, në rast se komuna nuk emëron inspektor/inspektore, kompetenca do të zbatohet nga inspektori/inspektorja shtetërore, në emër të komunës dhe me shpenzimet e komunës.

Aty ku funksionojnë, shërbimet inspektorale komunale të shumtën e rasteve formohen si njësi organizative, përkatësisht si sektore ose njësi-inspektorati, ose parashihet që mbikëqyrja inspektuese të zbatohet nga një inspektor/inspektore, i/e emëruar nga funksionari/funksionarja (kryetari/kryetarja). Sipas praktikës së deritanishme të komunave, inspektorëve/inspektoreve nuk u jepet licencë nga Këshilli Inspektorial, pra nuk japin provimin për inspektorë. Distinktivi që duhet duhet ta kenë inspektorët/inspektoret parashihet të jepet nga organi që i ka emëruar.

II.1. Llojet e mbikëqyrjes

Mbikëqyrja dhe kontrolli i kryerjes së detyrave të vetëqeverisjes lokale bëhet me zbatimin e disa llojeve të mbikëqyrjes:

Lloji i mbikëqyrjes	Organi kompetent për zbatimin e mbikëqyrjes
Mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e rregullave të komunës	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale përmes Inspektoratit Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale
Mbikëqyrje inspektuese mbi procedurën për miratimin e dispozitave komunale	Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale
Mbikëqyrje mbi ligjshmërinë dhe efikasitetin e punës së organeve komunale	Organet e administratës shtetërore kompetente për ndjekjen e ligjeve nën kompetencat e tyre
Mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës për zbatimin e detyrimeve të deleguara	Organet e administratës shtetërore kompetencat e të cilave i janë deleguar komunës
Mbikëqyrje e punës materiale dhe financiare të komunave	Ministria e Financave dhe organet e saj
Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin dhe aplikimin e ligjeve	Organet inspektorale

Sipas ligjit për mbikëqyrjen inspektuese, që definon procedurën për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese, mbikëqyrjen inspektuese inspektori e bën përmes:

- Mbikëqyrjes inspektuese të rregullt,
- Mbikëqyrjes inspektuese të jashtëzakonshme dhe
- Mbikëqyrjes inspektuese kontrolluese.

Mbikëqyrja inspektuese e rregullt është mbikëqyrje e paralajmëruar që bëhet në bazë të programit të punës të shërbimit inspektoral dhe përfshin mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe rregullave të miratuara në bazë të ligjeve. Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale bën mbikëqyrje inspektuese të rregullt përmes inspektimit dhe kontrollit të vendimeve të këshillave komunalë, që shpallen në buletin informativ komunal.

Mbikëqyrja inspektuese e jashtëzakonshme është mbikëqyrje e paparalajmëruar dhe kryhet në bazë të iniciativës së organeve shtetërore, subjekteve juridike ose personave, si dhe në rast dyshimi nga ana e inspektorit – në vijë zyrtare.

Mbikëqyrja inspektuese kontrolluese kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar me aktin inspektoral të miratuar nga inspektori, gjatë së cilës, me konstatimin e gjendjes faktike, inspektori mund të vijë në përfundim se subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar plotësisht sipas aktit inspektues, ka vepruar pjesërisht sipas aktit inspektues ose nuk ka vepruar sipas aktit inspektues. Mosveprimi ose veprimi i pjesërishtëm sipas aktit inspektues është bazë për zbatimin e masave inspektorale sipas ligjit.

II.2. Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e dispozitave të komunave

Sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale, anëtarët dhe anëtares e Këshillit kanë të drejtë dhe detyrë të marrin pjesë në punën e Këshillit dhe të ngrenë iniciativa a propozime, t'i parashtrojnë pyetje kryetarit/kryetares etj. Anëtari/anëtarja i/e Këshillit nuk mund të ndiqet penalisht ose të arrestohet për shprehjen e një mendimi dhe votimit në Këshill. Mbikëqyrja e ligjshmërisë së dispozitave që miraton Këshilli i Komunës përfshin edhe mbikëqyrjen e procedurës për miratimin e dispozitave të komunës. Këtë mbikëqyrje e bën Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale.

Përmes mbikëqyrjes së punës së Këshillit, kryetari/kryetarja ka të drejtë që një dispozitë të miratuar nga Këshilli ta kthejë për rishikim dhe

rishqyrtim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Në rast të rimiratimit në formë të njëjtë dhe pa hequr aspektet e kontestuara, kryetari/kryetarja ka për detyrë ta informojë Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe Inspektoratin Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale dhe njëkohësisht të nisë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së asaj dispozite para Gjykatës Kushtetuese.

Mbikëqyrja e punës materiale dhe financiare të komunës bëhet nga Ministria e Financave, përmes njësisë për buxhete lokale dhe përmes njësisë qendrore për harmonizim. Revizionin e punës materiale dhe financiare të komunës e bën Enti Shtetëror i Revizionit. Të gjitha raportet për revizionet e kryera shpallen në faqen e internetit të Entit Shtetëror të Revizionit: www.dzr.mk

Njësitë për revizionin e brendshëm në mënyrë të detyruar formohet në të gjitha subjektet e sektorit publik (duke përfshirë këtu edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale) të cilat kanë buxhet vjetor mesatar/plan financiar në tre vjetët e fundit që tejkalon shumë prej 50 milionë denarëve.

Që nga fillimi i procesit të decentralizimit, njësia qendrore për koordinim në kuadër të Ministrisë së Financave ndjek dhe koordinon procesin e emërimit të revizorëve/revizoreve të brendshëm/brendshme. Të dhënat për revizionin e brendshëm (RB) në nivel lokal deri në vitin 2014 jepen në tabelën në vazhdim.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	01/ 2018	06/ 2018
Njësitë e formuara për RB-në	0	17	32	40	49	59	64	65	71	71	71	70	70	71
Nr.i revizorëve të brendshëm	15	27	33	35	44	52	60	64	67	68	69	71	71	71
Nr.i raporteve nga RB-ja	88	107	134	132	172	176	147	183	163	143	138			
Rekomandimet	455	626	707	815	1033	1355	905	1382	981	966	772			
% e rekomandimeve të implementuara nga RB-ja	60	68	69	58	72	49	61	65	54	54	50			

Burimi: Ministria e Financave 2018

11.3. Aspektet kushtetuese-juridike të mbikëqyrjes

Nëse Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale konsideron se një dispozitë e caktuar e komunës nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe/ose ligjin, në afat prej 45 ditëve nga dita e dorëzimit të dispozitës sjell vendimin për ndalimin e zbatimit të asaj dispozite. Vendimi për ndalim shpallet në faqen e internetit të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale në afat prej 3 (tri) ditëve nga miratimi i tij, si dhe në Gazetën Zyrtare. Kundër vendimit për ndalim parashihet ankesë te komisioni shtetëror për vendimet e procedurës administrative dhe procedurës për marrëdhënie pune, në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa nuk anulon zbatimin e vendimit. Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale dorëzon iniciativë te Gjykata Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitës që paraprakisht është ndaluar me vendim.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese prodhon veprim juridik nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare: anulimin ose pezullimin e dispozitës së kontestuar. Zbatimi i akteve të plotfuqishme të miratuara në bazë të dispozitës së **anuluar** nuk mund të lejohet as të zbatohet, e në rast se zbatimi ka filluar, do të ndalohej.

Lidhur me iniciativën për verifikimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së një akti të caktuar, Gjykata Kushtetuese mund të deklarojë qëndrimin e vet në këto mënyra:

- Të sjellë vendim për REFUZIMIN e iniciativës për inicimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë;
- Të sjellë vendim për MOSINICIMIN e procedurës pas parashtrimit të iniciativës;
- Të sjellë vendim për INICIMIN e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitës së caktuar; dhe
- Të sjellë vendim për ANULIMIN e dispozitës së caktuar.

Në rast të anulimit të dispozitës, secili person të cilit i është shkelur e drejta me akt final ose te plotfuqishëm të miratuar mbi bazë të dispozitës së anuluar, ka të drejtë të kërkojë nga komuna ta anulojë atë akt në afat prej 6 muajve prej ditës së shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese në Gazetën Zyrtare.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese i zbaton Gjykata Kushtetuese.

III. Pjesëmarrja e qytetarëve dhe qytetareve në vendimmarrjen në nivel lokal

Krijimi dhe miratimi i politikave lokale është në interes të veçantë për qytetarët dhe qytetaret sepse ato ndikojnë në mirëqenien dhe përditshmërinë e tyre. Në përgjithësi komunikimi reciprok mes komunës dhe publikut mund të zhvillohet në disa nivele:

1. Informimi i publikut (mediat e shkruara dhe elektronike e të tjerë);
2. Konsultimi me qytetarët dhe qytetaret (grupe fokusi, sondazhe, takime publike etj.);
3. Përfshirja e qytetarëve dhe qytetareve në proceset e politikave publike, që të sigurohet se do të kuptohen dhe do të merren parasysh mendimet e palëve të ndryshme që janë relevante;
4. Bashkëpunimi me qytetarët dhe qytetaret – vendosja e partneriteteve me grupe të ndryshme interesi në secilën fazë të zhvillimit të politikave publike, që nga identifikimi i problemit deri tek evaluimi (p.sh.: këshillime, komisione të ndryshme, vendimmarrje pjesëmarrëse);
5. Përforcimi i rolit të grupeve të ndryshme të interesit nga ana e pushtetit për zbatimin e politikave publike, me çka vendimi dhe përgjegjësia për t'u arritur qëllimet e përcaktuara përcillet te këto grupe, ndërsa marrja e vendimeve përfundimtare bëhet me pjesëmarrjen e publikut.

**Organet e komunës, kanë për detyrë, pa kompensim,
t'i informojnë qytetarët dhe qytetaret për punën e tyre**

Në këtë mënyrë, organet e komunës, komisionet e Këshillit dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna kanë për detyrë, pa

kompensim, t'i informojnë qytetarët dhe qytetaret për punën e tyre dhe për planet dhe programet që janë me rëndësi për zhvillimin e komunës.

Rëndësia dhe e drejta për informimin e publikut është e garantuar me ligjin për vetëqeverisjen lokale, i cili parasheh që puna e Këshillit, përkatësisht seancat e tij të jenë të hapura. Përjashtimi i publikut nga seancat e Këshillit mund të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, kur shumica e dy të tretave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit vendosë ashtu, për shkaqe objektive të parapara me statut. Për çështjet e rëndësisë së veçantë, siç janë debatet për buxhetin e komunës, bilancin vjetor dhe planet urbanistike, publiku nuk mund të përjashtohet nga seancat e Këshillit.

Përveç informimit të vazhdueshëm të publikut nga ana e organeve komunale, përfshirja e tij e drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes ka rëndësi thelbësore për demokracinë lokale. Kjo mundëson rritjen e transparencës dhe njëkohësisht i bën funksionarët lokalë më të përgjegjshëm gjatë vendimmarrjes. Bëhet fjalë për një proces të vazhdueshëm, që mbulon periudhën mes dy cikleve të zgjedhjeve lokale dhe gjatë të cilit bëhet shpërndarje dykahëshe informatash, për politikën lokale dhe pushtetin lokal.

III.1. Baza juridike për pjesëmarrjen qytetare në vend

Zgjedhjet lokale janë hapi i parë në përfshirjen e qytetarëve dhe qytetareve në procesin e vendimmarrjes, ndërsa përfshirja e tyre e vazhdueshme në punën e komunës vazhdon mes dy cikleve zgjedhore, bashkëpunim ky i paraparë me ligjet, statutet dhe aktet komunale.

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve dhe qytetareve në procesin e vendimmarrjes në komuna definohet në ligjin për vetëqeverisjen lokale, ku parashihen këto mënyra të pranuar ligjërisht të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë qytetare:

- Iniciativa qytetare
- Tubimet e qytetarëve¹
- Referendumi

Po ashtu, me forma plotësuese të përfshirjes së publikut në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, parashihen edhe:

- Parashitja dhe propozime, dhe
- Tribuna publike, sondazhe dhe propozime publike.

¹ Formulimi për termin "Tubimi i qytetarëve" është marrë nga ligji për vetëqeverisjen lokale dhe për të qenë në përputhje me ligjin, nuk është shtuar termi "qytetare"

Shpenzimet për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje mbulohej nga buxheti i komunës.

III.2. Mënyra të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve

Karakteristikat kryesore të formave të veçanta të pjesëmarrjes qytetare paraqiten në tekstin në vazhdim.

Iniciativa qytetare

Me iniciativë qytetare nënkuptohet e drejta e qytetarëve t'i propozojnë Këshillit të miratohet akt të caktuar ose të zgjidhë çështje të caktuara, në bazë të kompetencave që ka. Me akt nënkuptohet statut, program, plan, vendim ose lloj tjetër rregulloresh që miratohen në nivel lokal.

Iniciativa qytetare nuk mund të ndërhyjë në çështje të burimeve njerëzore dhe financiare. Për të gjitha çështjet e tjera, Këshilli ka detyrë të debatojë nëse iniciativën e përkrahin së paku 10% e votuesve të komunës, përkatësisht e votuesve të bashkësisë vetëqeverisëse me të cilën ka të bëjë çështja e caktuar.

Këshilli ka detyrë ta shqyrtojë iniciativën përkatëse në afat prej 90 ditëve nga dita e dorëzimit të kësaj iniciative dhe t'i informojë qytetarët dhe qytetarët për vendimin e vet.

Tubimi i qytetarëve

Në pajtim me ligjin për vetëqeverisjen lokale, tubim qytetarësh mund të caktohet për gjithë territorin e komunës ose për territorin e bashkësisë lokale.

Tubim qytetarësh mund të ketë:

- Me iniciativën e kryetarit/kryetares së komunës,
- Me kërkesën e Këshillit të Komunës
- Me kërkesën e të paktën 10% të votuesve të komunës, përkatësisht bashkësisë lokale me të cilën ka të bëjë çështja e caktuar.

Pa marrë parasysh arsyen për të cilën thirret tubimi i qytetarëve, administrata komunale është plotësisht përgjegjëse për realizimin dhe organizimin logjistik të procesit, përfshirë këtu edhe shpërndarjen e

informatave mes qytetarëve e qytetareve dhe organeve të komunës (kryetarit/kryetares dhe anëtarëve e anëtareve të Këshillit të Komunës). Organet e komunës janë të detyruara në afat prej 90 ditëve t'i shqyrtojnë përfundimet e miratuara nga tubimi i qytetarëve dhe t'i kenë parasysh gjatë vendimmarrjes dhe miratimit të masave për çështjet përkatëse, si dhe t'i informojnë qytetarët dhe qytetaret për vendimet e tyre.

Referendumi

Referendumi është mënyra më legjitime për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe qytetareve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Me atë përfshihen çështje që janë pjesë e kompetencave të vetëqeverisjes lokale, nga sfera e:

1. Buxhetit
2. Financave
3. Organizimit të administratës komunale.

Ligji për vetëqeverisjen lokale i cili definon çështjen e organizimit të referendumit në nivel lokal, parasheh:

- Këshilli ka detyrë të shpallë referendum me kërkesë të së paku 20% të votuesve të komunës.
- Këshilli, me vetiniciativë, mund të shpallë referendum për çështje lidhur me kompetencat që ka.
- Vendimi i sjellë në referendum është i detyrueshëm për Këshillin.

Parashtresa dhe propozime

Secili/a qytetar/qytetare i/e komunës ka të drejtë, individualisht apo së bashku me të tjerët, të dorëzojë parashtresa dhe propozime për punën e organeve të komunës dhe administratës komunale.

Kryetari/kryetarja ka për detyrë:

- të krijojë kushte për dorëzimin e parashtresave dhe propozimeve;
- t'i kthejë parashtruesit përgjigje të argumentuar hollësisht në afat prej 30 ditëve nga pranimi i parashtresës, përkatësisht propozimit; ato parashtresa dhe propozime të cilat nuk kanë të bëjnë me çështje nën kompetenca të organeve të komunës, duhet t'i dorëzojë tek organi kompetent përkatës dhe për këtë ta informojë parashtruesin.

Të shumtën e rasteve parashtrirat dhe propozimet kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve që komuna ua ofron qytetarëve, organizimin, procedurat, formularët, qasshmërinë e zyrtarëve/zyrtareve komunale shtetërore, qasjen tek informatat, si dhe me njohurinë dhe sjelljen e zyrtarëve/zyrtareve shtetërore etj.

Tribuna, sondazhe dhe propozime publike

Gjatë përpilimit të rregulloreve të komunës dhe marrjes së vendimeve me rëndësi lokale, Këshilli dhe kryetari/kryetarja paraprakisht mund të organizojnë tribuna publike, të realizojnë sondazhe ose të kërkojnë propozime nga qytetarët dhe qytetaret. Qëllimi është që të miratohen rregullore cilësore, për ç'gjë meritore do të jenë edhe banorët e komunës, e kjo do të ndikojë pozitivisht në implementimin e këtyre rregulloreve.

Ekzistojnë edhe shumë teknika të tjera të pjesëmarrjes qytetare që përdoren në vend dhe jashtë vendit, e që ndërmerren me iniciativë të udhëheqësive komunale. Do të numërojmë vetëm disa: grupe këshilldhënëse qytetarësh/qytetaresh, planifikimi strategjik nëpër komuna, buxheti participativ, mbikëqyrja shoqërore, partneritetet publiko-private etj.

Forume në komunitet

Edhe pse si formë e pjesëmarrjes qytetare nuk parashihet në ligjin për vetëqeverisjen lokale, forumi në komunitet është mekanizëm i dobishëm për përfshirjen aktive të qytetarëve dhe qytetareve në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal. Një numër i madh komunash në vend që tani më janë kyçur në iniciativën për organizim të forumeve, kanë pasur përvoja pozitive nga këto forume. Në vitin 2010, me propozim të Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale–BNJVL, njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë filluar ndryshime dhe plotësime të statuteve të tyre në pjesën që përcakton pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe qytetareve, përfshirë këtu edhe forumet në komunitet si një formë plotësuese në përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjeve me rëndësi lokale.² Te forumet për buxhetin temë diskutimi është buxheti i komunës, kurse diskutimi bëhet rreth mënyrës se si komuna planifikon dhe shpenzon buxhetin e saj dhe cilat janë programet dhe projektet prioritare në kuadër të programeve.

² BNJVL: Forumi në bashkësi me 11 hapa, Doracak, 2017

III.3. Elementet e duhura për pjesëmarrje qytetare efektive

Që të sigurohet pjesëmarrja publike në proceset demokratike në shoqëri, duhet të ekzistojnë katër elemente kyçe: rregullativë e fuqishme, kulturë pjesëmarrjeje ku secili individ merr pjesë në mënyrë aktive në komunitet dhe në vlerat kolektive, vullnet politik i pushtetit dhe udhëheqje e mirë me proceset e pjesëmarrjes publike dhe konsultimet. Me fjalë të tjera kjo nënkupton ekzistimin e parakushteve në vijim:

- Qytetarë dhe qytetare të motivuar/a, të arsimuar/a dhe të vetëdijësuar/a;
- Forcë lëvizëse e këtij procesi duhet të jenë vetë qytetarët dhe qytetaret e interesuar/a;
- Administrata komunale duhet të krijojë ambient të volitshëm për pjesëmarrje qytetare, kanale përkatëse për shpërndarjen e informatave, të sigurojë mbështetje logjistike, të sigurojë udhëheqje të procesit, si dhe resurse financiare dhe njerëzore;
- Të gjitha palët e përfshira duhet t'í dinë metodat e pjesëmarrjes qytetare;
- Qytetarët dhe qytetaret duhet të edukohen në mënyrë përkatëse për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në drejtim të vetëqeverisjes lokale dhe procesit të vendimmarrjes;
- Përfitimet nga procesi duhet të jenë patjetër në dobi të qytetarëve dhe qytetareve, administratës komunale dhe komunitetit lokal;
- Të dyja palët duhet të jenë transparente në veprimin e tyre, sidomos vetëqeverisja lokale;
- Të dyja palët duhet të jenë fleksibile dhe të hapura për negociim dhe bashkëpunim;
- Sipas nevojës, duhet të kërkohet ndihmë nga ekspertë të jashtëm, përfshirë edhe ekspertë të edukimit publik, zhvillimit ekonomik lokal, buxhetimit, organizimit të tribunave publike etj.

Vendimmarrja e përbashkët mundëson që të ndahet përgjegjësia për vendimet

Vendimmarrja e përbashkët mundëson që të ndahet përgjegjësia për vendimet, me çka pushtetet lokale nuk janë bartësit e vetëm të “barrës”, ndërsa qytetarët dhe qytetaret nuk i përjetojnë vendimet e marra si “të huaja”, por zhvillojnë ndjenjën e pronësisë mbi vendimet, e kështu do të jenë të interesuar për ta ndjekur realizimin e tyre, pra do të kërkojnë llogari. Mirëpo, mekanizmat për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje nuk zbatohen çdoherë. Me procesin e decentralizimit edhe më shumë theksohet nevoja për konsultim dhe komunikim të rregullt me qytetarët për tema dhe çështje të sferave të ndryshme. Përdorimi i mekanizmave për përfshirjen e qytetarëve është me rëndësi kyçe në mjedise multietnike, aty ku mosgjdhja e problemeve praktike nga jeta e përditshme e qytetarëve mund të marrë konotacion etnik dhe të nxisë tension të panevojshëm, destabilizim dhe më pak siguri.

III.4. Pengesa për pjesëmarrjen qytetare

Si pengesa më të shpeshta për pjesëmarrjen qytetare efektive mund të llogariten këto në vijim:

- Mungesa e besimit të ndërsjellë mes qytetarëve/qytetareve dhe vetëqeverisjes lokale;
- Qasja e kufizuar tek informatat për qytetarët dhe qytetaret;
- Mungesa e motivimit dhe përpjekjeve për bashkëpunim (te të dyja palët);
- Njohuria dhe vetëdija e kufizuar e qytetarëve dhe qytetareve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Mungesa e aftësive, kulturës së pjesëmarrjes dhe përvojës;
- Pritjet joreale;
- Ngatërrimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje me organin konkret vendimmarrës;
- Mungesa e kapaciteteve (njerëzore, financiare, hapësinore etj.) nëpër komuna, sidomos në komunat rurale;
- Aftësitë dhe kapacitetet e kufizuara të vetëqeverisjes lokale të ndërmjetësorë në pjesëmarrjet e këtilla.

Në lidhje me gjitha këto që u cekën më lart, për tejkalimin e pengesave mund të rekomandohen mënyrat në vijim:

- Edukimi dhe trajnimi publik, të organizuar nga pushtetet lokale;
- Angazhimi më i madh i anëtarëve të Këshillit për realizimin e kontakteve dhe komunikimit me qytetarët dhe qytetaret për çështje të caktuara;
- Fushatat për ndërgjegjësimin e publikut;
- Realizimi i strategjive për komunikim;
- Zhvillimi i partneritetit me palët kyçe në komunitet;
- Mbledhja e mjeteve financiare;
- Shpërndarja përkatëse e informatave;
- Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave në vetëqeverisjen lokale;
- Inicimi për zbatimin konkret të instrumenteve për pjesëmarrje.

Në korrik të vitit 2016, Misioni i OSBE-së në Shkup mbështeti realizimin e hulumtimit të opinionit publik për pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën politike në vend. Edhe pse 58% e të anketuarve nga ky hulumtim mendojnë se përmirësimi i gjendjes në komunitet varet nga pjesëmarrja e tyre personale a individuale, prapëseprapë 55% prej tyre janë përgjigjur se nuk janë të motivuar të marrin pjesë në aktivitete me interes shoqëror ose publik. Si arsye kryesore për këtë përmendin mungesën e kohës së mjaftueshme, si dhe mosbesimin se pjesëmarrja e tyre do të bënte ndonjë ndryshim. Me rëndësi është të ceket se 26% e të anketuarve në sondazhin publik kanë deklaruar se do të motivoheshin të marrin pjesë në aktivitete me interes publik nëse shohin ndryshim pozitiv në realizimin e disa prej kërkesave të qytetarëve dhe qytetareve drejtuar pushtetit, ose nëse numri më i madh i banorëve do të përkrahnin ndonjë iniciativë të caktuar.

Të gjitha këto rezultate duhet t'i shërbejnë pushtetit lokal – Këshillit dhe kryetarit/kryetares- për të vendosur mekanizëm më efikas për përfshirjen e qytetarëve dhe qytetareve në procesin e vendimmarrjes.

IV. TRANSPARENCA NË PUNË NË NIVEL LOKAL

Demokracia është ajo qeverisje/udhëheqje ku të gjithë qytetarët në moshë madhore ushtrojnë fuqinë dhe përgjegjësinë qytetare në mënyrë direkte ose indirekte, përmes përfaqësuesve/përfaqësueseve të zgjedhur/a në zgjedhje të lira.

- Demokracia bazohet në principin e qeverisjes së shumicës, që do të thotë se vendimet që miratohen nga shumica duhet të pranohen nga të gjithë, mirëpo duhet të respektohen edhe qëndrimet e pakicës.
- Në shoqëritë demokratike pushteti qendror përcaktohet për decentralizimin e pushtetit në nivel lokal, duke qenë i vetëdijshëm se problemet lokale zgjidhen me më shumë sukses në rrafsh lokal;
- Demokratët organizojnë zgjedhje të rregullta, të lira dhe korrekte për të gjithë qytetarët me të drejtë vote;
- Në shoqëritë demokratike qytetarët kanë të drejta dhe përgjegjësi të marrin pjesë në jetën politike;
- Në shoqëritë demokratike respektohen vlerat e tolerancës, bashkëpunimit dhe kompromisit.

Parimet themelore të qeverisjes demokratike jepen në tabelën në vijim:

Parimet e qeverisjes demokratike

35

1. Pjesëmarrja qytetare: qytetarët janë pjesë e procesit të vendimmarrjes për çështje që kanë të bëjnë me ta; para se të sillet vendimi, komunikimi është një proces dykahësh, konsultativ – prej poshtë lart dhe prej lart poshtë.

2. Barazia: kjo do të thotë barazi para ligjit, barazi për mundësitë për realizimin e kapaciteteve individuale, pa marrë parasysh racën, gjininë, përkatësinë etnike, religjionin etj.

3. Toleranca politike: strukturat qeverisëse duhet të kenë vetëdije të lartë dhe t'i respektojnë interesat e pakicës;

4. Llogaridhënia: liderët/lideret e zgjedhur/a ose zyrtarët/zyrtaret publikë/e duhet të përgjigjen para qytetarëve të thjeshtë për veprimet dhe vendimet e tyre, e madje edhe për mossjelljen e vendimeve;

5. Transparenca: funksionarët lejojnë hetim publik për punën që bëjnë derisa janë në funksion publik, duke lejuar qytetarët të jenë të pranishëm në takimet e hapura dhe të marrin informata;

6. Zgjedhjet e lira dhe korrekte: zgjedhjet e lira dhe korrekte qytetarëve dhe qytetareve u japin mundësi vetë të zgjedhin liderë/lidere. Parregullsitë dhe shkelja e procesit zgjedhor mund të sjellë në pushtet përfaqësues/përfaqësuese që shumica nuk i do;

7. Liria ekonomike: qytetarë të hendikepuar ekonomikisht janë ata qytetarë që kanë tendencë keqpërdorimi, sepse u mungon bazë ekonomike për t'i përmbushur nevojat elementare jetësore;

8. Kontrolli mbi keqpërdorimin e fuqisë: pa pasur kontroll të kompetencave, është e madhe mundësia që secila qeveri t'i keqpërdorë ato.

9. Të drejtat e njeriut: për dallim nga diktaturat, qëllimi i demokracive është t'i mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve të vet nga keqpërdorimi;

10. Sistemi shumëpartiak: arsyeja për ekzistimin e më shumë partive është që të ketë zgjedhje më të madhe për kandidatin/kandidaten më të mirë për funksionin politik;

11. Neutraliteti i institucioneve shtetërore: institucionet shtetërore, policia dhe armata, duhet të jenë neutrale dhe të mos mbajnë anë e as të përfaqësojnë interesa të ngushtë partiakë;

12. Sundimi i së drejtës: të gjithë qytetarët duhet ta respektojnë ligjin dhe të ballafaqohen me sanksione nëse e shkelin atë.

Burimi: "Konrad Adenauer Shtifung": Konceptet dhe parimet e qeverisjes dhe llogaridhënies demokratike, 2011 (Konrad-Adenauer-Stiftung: Concepts and Principles of Democratic Governance and Accountability, 2011).

IV.1. Zbatimi i PARIMEVE të transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunalë

Bazat e transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunalë parashihen me ligjin për vetëqeverisjen lokale, ligjin për qasjen e lirë tek informacione me karakter publik dhe ligjin për përdorimin e të dhënave nga sektori publik.

Sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale, seancat e Këshillit janë të hapura. Për të mbajtur seancë të mbyllur për opinionin vendoset vetëm nëse për këtë ekzistojnë shkaqe objektive, të parapara me statutin e komunës. Për ta shpallur seancën të mbyllur për opinionin vendoset me dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve/anëtareve të Këshillit.

Sipas ligjit për qasjen e lirë tek informacionet me karakter publik, posedues të informacioneve me karakter publik janë edhe organet e komunës, të Qytetit të Shkupit dhe organet e komunave të Qytetit të Shkupit. Informacion i karakterit publik është ai informacion i çfarëdo forme, i krijuar dhe në dispozicion të poseduesit të informacionit, përkatësisht ai informacion është vetëm në pronësi të poseduesit të informacionit, në përputhje me kompetencat e veta. Rrjedhimisht, kërkues i informacionit është secili subjekt juridik ose person fizik, i padiskriminuar në çfarëdo baze, në mënyrë dhe me kushte të parapara me ligj.

Në ligjin për përdorimin e të dhënave nga sektori publik përcaktohet detyrimi i organeve dhe institucioneve të sektorit publik për shpalljen publike të të dhënave, të cilat i krijojnë gjatë ushtrimit të kompetencave të veta në bazë të ligjit. Qëllimi i tij është përdorimi i të dhënave nga sektori publik, mes tjerash, të nxisë përfshirjen sociale, llogaridhënie dhe transparencë më të madhe në sektorin publik.

Pse nevojitet transparencë në punën e pushtetit dhe këshillit komunal?

Parimet e qeverisjes demokratike imponojnë që qytetarët dhe qytetarët të jenë çdoherë të informuar dhe të konsultuar për realizimin e programeve që janë me rëndësi të madhe për përmirësimin e kushteve për jetesë në bashkësinë e tyre lokale. Për shkallën e realizimit të programeve të premtuara, qytetarët dhe qytetarët duhet patjetër të jenë të informuar në kohë, për të rritur mirëbesimin te puna e pushtetit lokal, që paraqet investim për sigurimin e mbështetjes në të ardhmen.

IV.2. Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunalë

Transparenca e përfaqësuesve të zgjedhur në këshill nuk duhet të mbarojë ditën e zgjedhjeve dhe me themelimin e këshillave komunalë!

Çfarë domethënë zbatimi i parimit të transparencës në punën e këshillit komunal?

Transparenca nënkupton qarkullimin e lirë të informatave në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Bartësit/bartëset e funksioneve publike detyrohen të ndajnë dhe të kërkojnë informata të kthyese lidhur me të gjitha veprimet sjellin ndryshime për mirëqenien e komunitetit. Transparenca nevojitet në publikimin në kohë të informatave për aktivitetet e planifikuara, vendimet e miratura dhe hapat e realizuar.

Transparenca nënkupton publikimin në kohë të informatave për aktivitetet e planifikuara, vendimet e miratuara dhe hapat e realizuara

Vetë pushteti lokal ka për detyrë ta gjejë mënyrën më të mirë për informimim e publiku. Mënyrat e informimit të qytetarëve dhe qytetareve mund të jenë të ndryshme – përmes tabelave të shpalljeve, takimeve të hapura, gazetave, radios, televizionit, internetit etj. Varësisht nga struktura e popullsisë në rajone të caktuara të komunës, duhet të gjendet mënyra më e qëlluar se si të mbërrijë informata te qytetarët dhe qytetaret. Në raste të veçanta komuna do t'i përdorë mediat elektronike si mjet komunikimi, e në raste tjera – për shkak të përqindjes së vogël të popullatës me qasje në internet, ky kanal mund të jetë krejtësisht i papërshtatshëm. Në rast të tilla do të përdoren kanale alternative si mediat e shkruara, tabelat e shpalljeve, takimet e drejtpërdrejta në komunitete urbane e të ngjashme.

Qytetarët dhe qytetaret kanë të drejtë ta dinë si i i realizon pushteti premtimet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore, cilat vendime realizohen, cilat vendime nuk realizohen dhe për ç'arsye, dhe në çfarë mase realizohen projektet vjetore. Pushteti lokal duhet të konsultohet me qytetarët dhe qytetaret që prej fazës së përcaktimit të prioriteteve lidhur me shfrytëzimin e burimeve publike, për të kënaqur nevojat publike të pjesës më të madhe të popullatës. Këtë detyrim në mënyrë të barabartë e kanë edhe kryetari/kryetarja, edhe anëtarët/anëtares e Këshillit.

Më konkretisht, transparenca në punën e Këshillit ka të bëjë me:

- Publikimin në kohë të informatave për mbajtjen e seancave të Këshillit
- Publikimin në kohë të rendit të ditës për seancat e Këshillit
- Publikimin e procesverbaleve nga seancat e mbajtura
- Transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të Këshillit
- Praninë e qytetarëve dhe qytetareve të interesuar/a në seancën e Këshillit
- Konsultimin me qytetarët dhe qytetaret para miratimit të vendimeve të caktuara në Këshill
- Të tjera.

Transparenca dhe llogaridhënia si parime të qeverisjes demokratike janë dy anë të një rrëfimi që titullohet qarkullim i lirë i informatave nga komuna dhe institucionet publike në nivel lokal drejt qytetarëve dhe qytetareve dhe anasjelltas.

**Publiku ka të drejtë të dijë se si shpenzohen
burimet lokale dhe me ide dhe propozime të
kontribuojë për udhëheqje të mirë**

Çfarë është zbatimi i parimit demokratik të llogaridhënies në punën e këshillave komunalë?

Llogaridhënia nënkupton shkëmbimin e informacioneve të sakta dhe të rëndësishme mes komunës dhe qytetarëve e qytetareve lidhur me aktivitetet e ndërmarra me interes publik. Publiku ka të drejtë të dijë se si shpenzohen burimet lokale dhe me ide dhe propozime të kontribuojë për udhëheqje më të mirë dhe për përmbushjen sa më cilësore të nevojave. Informimi i rregullt dhe cilësor rrit besimin në pushtetin lokal dhe kontribuon për përforcimin e disiplinës fiskale.

Nëse qytetarët dhe qytetaret janë të bindur se pushteti lokal i përdor resurset në mënyrë efektive dhe efkase, do të motivohen që në mënyrë të rregullt dhe në kohë t'i shlyejnë detyrimet e veta financiare ndaj komunës. Me këtë ata kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës në bashkësinë e tyre lokale. Transparenca më e lartë fiskale mundëson diskutim më të hapur publik dhe arritje konsensusi për prioritetet dhe politikat e pushtetit, njëkohësisht duke pasur ndikim pozitiv mbi zvogëlimin e korrupsionit dhe

sjelljes joetike të bartësve/bartëseve të funksioneve publike. Për këtë shkak, transparenca dhe përgjegjësia e pushtetit lokal nuk duhet të shihen në mënyrë të pavarur, por si pjesë përbërëse e së mirës së përgjithshme dhe funksionimit demokratik.

Publikimi i vazhdueshëm i informacioneve garanton se publiku është i informuar për vendimet që kanë të bëjnë me të dhe kjo kontribuon për përforcimin e sundimit të së drejtës, nxit të shpenzuarit e përgjegjshëm të mjeteve publike dhe promovon integritetin në nivel komune. Shkëmbimi i informacioneve se si funksionon komuna ndihmon publikun t'u qaset shërbimeve shtetërore. Zhvillimi i hovshëm i internetit jep mundësinë për rritje transparence, sepse mundëson publikim të shumë informatave me shpenzime të ulëta. Qendra për Komunikime Civile në maj të vitit 2018 kreu një hulumtim për të përcaktuar indeksin e transparencës aktive 2018.³ Sipas metodologjisë hulumtuese, komunat janë pyetur për katër kategori pyetjesh:

Qasja tek informacionet

- A ekziston faqe interneti dhe department i veçantë për qasjen tek informacionet;
- A qëndron emri i personit zyrtar për qasjen tek informacionet;
- A qëndrojnë të dhënat themelore për kontaktin me institucionin përkatës;
- A është publikuar lista e informacioneve me të cilat disponon komuna;
- A janë publikuar aktet me të cilat përcaktohen kompetencat e komunës;
- A janë publikuar programe, strategji, studime, opinione lidhur me kompetencat e komunës;
- A është publikuar statuti i komunës

Informatat për kompetencat dhe shërbimet

- A janë publikuar buletinet zyrtare të komunës;
- A është publikuar rendi i ditës për seancat e Këshillit;
- A janë publikuar vendimet e Këshillit;

³ Qendra e Komunikimit Qytetar: Indeksi i transparencës aktive 2018.

- A është publikuar struktura organizative e komunës;
- A janë publikuar emrat e të gjithë të punësuarve dhe të dhënat për kontakt;
- A publikohet buletini informativ i komunës

Transparenca buxhetore dhe financiare

- A publikohen buxhetet e komunës;
- A publikohen buxhetet qytetare të komunës;
- A publikohen raporte kuartale për realizimin e buxheteve;
- A publikohen bilancet vjetore të buxheteve;
- A publikohet plani vjetor për furnizimet publike;
- A publikohen shpallje për furnizimet publike;
- A publikohet dokumentacioni i duhur për tenderim;
- A publikohen lajmërimet për kontraktimet për furnizimet publike me anekse

Informacione për kompetencat specifike të komunave

- A është publikuar plani urbanistik i përgjithshëm;
- A janë publikuar planet urbanistike të detaluara;
- A publikohen lejet e dhëna për ndërtim;
- A publikohen informatat për të gjitha kompetencat komunale;
- A është publikuar informatë për përqindjen e tatimeve të pronës;
- A është publikuar informatë për përqindjen e taksave komunale dhe administrative

Indeksi i transparencës aktive të komunave për vitin 2018 është 39%. Përfundim i përgjithshëm i hulumtimeve të bëra është rënia e transparencës aktive të NJVL-ve për 6 përqind në vitin 2018 në raport me vitin 2016 (45%) dhe 2 përqind në raport me vitin 2017 (41%). Kjo është arsye e mjaftueshme për të ndërmarrë aktivitete përkatëse nga të gjitha organet komunale, për të përmirësuar gjendjen e konstatuar.

V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL

Përcaktimi i formave të bashkëpunimit ndërkomunal lidhet me zbatimin e PARIMEVE demokratike të efikasitetit dhe efektivitetit në funksionimin e njësive të vetëqeverisjes lokale gjatë ushtrimit të kompetencave të parapara me ligj. Bashkëpunimi ndërkomunal, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, është aktivitet vullnetar i komunave. Bashkëpunimi ndërkomunal vendoset mes dy ose më shumë komunave me qëllim të kryerjes më efikase dhe më ekonomike të kompetencave të komunës të parapara me ligj dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta. Bashkëpunimi ndërkomunal, ashtu si dhe vetë decentralizimi parë nga një këndvështrim më i gjerë, është përpjekje e përbashkët e pushtetit lokal dhe atij qendror. Po ashtu, ai është një nga mënyrat për realizimin e qëllimeve të pushtetit qendror për rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të komunave, si dhe për sigurimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe qytetaret.

Bashkëpunimi ndërkomunal vendoset mes dy ose më shumë komunave me qëllim të kryerjes më efikase dhe më ekonomike të kompetencave të komunës

V.1 Korniza ligjore për bashkëpunim ndërkomunal

Bashkëpunimi ndërkomunal përfshin dy ose më shumë komuna fqinje, që punojnë bashkërisht për të kryer detyra administrative komunale, shërbime publike për qytetarët dhe për të nxitur zhvillimin lokal në mënyrë më efikase dhe efektive. Mundësia për bashkëpunim ndërkomunal për herë të parë u mundësua me ligjin për vetëqeverisjen lokale, i cili parasheh që bashkëpunimi ndërkomunal të inkorporohet në secilën prej kompetencave komunale. Përveç kësaj, ligji për bashkëpunimin ndërkomunal përkufizon:

- Bashkëpunimin ndërkomunal si bashkëpunim që vendoset mes dy ose më shumë komunave, për kryerjen më efikase e më ekonomike të kompetencave të parapara me ligj dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta;

- Bashkëpunimin ndërkomunal edhe si: kryerjen e detyrave nën kompetencat e komunave nga njëra komunë, për llogari të një ose më shumë komunave tjera, në bazë të marrëveshjes mes po atyre komunave.

Me ligj përcaktohet procedura për zyrtarizimin e bashkëpunimit ndërkomunal, format nëpërmjet të cilave do të realizohet ky bashkëpunim, nxitja, ndjekja dhe financimi i bashkëpunimit ndërkomunal, evidenca dhe mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe përgjegjësitë për shpalljen e akteve/vendimeve për bashkëpunimin ndërkomunal.

V.2 Modelet e ndryshme të bashkëpunimit ndërkomunal

Shërbime të përbashkëta

Ky model i bashkëpunimit ndërkomunal parasheh bashkëpunim afatgjatë në formë të subjekteve të përbashkëta juridike (ndërmarrje, ente, asociacione, fondacione etj.). Këto organe të përbashkëta i udhëheqin shërbimet që sigurojnë, siç janë: mbrojtja nga zjarret, furnizimi me ujë, furnizimi me gaz/energji elektrike, mirëmbajtja e rrugëve, shërbimet nga sfera sociale, kultura, sporti etj. Po ashtu mund të nënkuptojë bashkëpunimin ose bashkërenditjen e burimeve për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Burimet që bashkohen mund të jenë njerëzore, financa ose pajisje të ndryshme teknike.

Për shembull: komuna e Ohrit dhe komuna e Strugës si formë të bashkëpunimit ndërkomunal kanë formuar ndërmarrjen publike për furnizim me ujë "Proaqua".

Administrimi i përbashkët

Vendosja e administratës së përbashkët mund të përfshijë shumë sfera të ndryshme nga kompetencat komunale, siç janë mbledhja dhe administrimi i tatimeve, planifikimi hapësinor (përfshirë planifikimin dhe licencimin e objekteve), kryerja e kontrollit inspektues, revizioni i brendshëm etj. Shembull për këtë lloj bashkëpunimi është hapja e zyrave të përbashkëta ose njërive organizative (sektorë, njësi), që me kompetencat që kanë, kryejnë shërbime për dy ose më shumë komuna partnere. Praktika evropiane na mëson se format për administrim të përbashkët përfshijnë këshilla për bashkëpunim ndërkomunal dhe komisione administrative e mbikëqyrëse. Struktura administrative e zyrave ose njërive organizative në të gjitha rastet është në shërbim të interesave të dy ose më shumë komunave.

Për shembull: me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit për ndarjen territoriale në vitin 2013, u bashkuan pesë komuna: Kërçova, Drugova, Vraneshtica, Zajazi dhe Oslomeja. Kjo imponoi formimin e administratës së përbashkët, e cila u shërben qytetarëve dhe qytetareve të komunave të bashkuara në kuadër të komunës së re të Kërçovës.

Shitja dhe blerja shërbimeve mes pushteteve lokale

Ky model zbatohet në situatën kur komunat administrative dhe/ose financiare më të fuqishme, për shumë të caktuar, u sigurojnë shërbime komunave me kapacitet më të dobët, e kjo mund të nënkuptojë edhe administrimin dhe sigurimin e shërbimeve. Shitja dhe blerja e shërbimeve mes komunave paraqet rast klasik që synon të arrijë racionalizimin ekonomik gjatë dhënies së shërbimeve dhe realizimin e qëllimeve.

Për shembull: në vendin tonë ekziston një praktikë në më shumë sfera, f.v. në sferën e revizionit të brendshëm, planifikimit urban, mbikëqyrjes inspektuese etj., ku një komunë, për një kompensim të caktuar, kryen shërbim për një komunë tjetër. I këtillë është shembulli me komunën e Velesit, e cila kryen shërbime për komunën e Çashkës dhe komunën e Llozovës, pastaj shembulli me komunën e Gostivarit për komunat e Mavrovë-Rostushes dhe Vrapçishtit etj.

Planifikimi dhe zhvillimi i përbashkët

Planifikimi dhe zhvillimi i përbashkët zbatohet në sfera ku një komunë nuk mund t'i ushtrojë kompetencat e veta për shkak të mungesës së resurseve për zhvillim ekonomik, zhvillim të turizmit, mbrojtje të mjedisit jetësor etj. Me planifikim të përbashkët arrihet edhe shkallë më e lartë e sinergjisë në një territor më të gjerë, që nuk kufizohet vetëm me një komunë, por me më shumë komuna të përfshira në iniciativë.

Për shembull: kjo formë bashkëpunimi realizohet në kuadër të të gjitha tetë rajoneve planifikuese në vend. Në periudhën e ardhshme nevojitet intensifikimi i bashkëpunimit dhe përmirësimi i bazës financiare për financimin e projekteve të përbashkëta.

Financimi i përbashkët

Financimi i përbashkët praktikohet kur më shumë komuna fqinje kërkojnë shkrirjen e fondeve të përbashkëta, ndërsa bashkëveprojnë për të ndarë barrën financiare. Kjo domethënë se bashkojnë resurset dhe

bashkërisht marrin vendime për investime, e me këtë ndahet edhe gjithë barra nga rreziqet përcjellëse.

Si faktorë plotësues që duhet t'i inkurajojë komunat të vendosin bashkëpunim ndërkomunal janë edhe këta në vazhdim:

- Pritjet e qytetarëve për rritjen e spektrit të shërbimeve dhe përmirësimin e cilësisë së këtyre shërbimeve;
- Qasja më e lehtë në tregun e kapitalit dhe financimi i përbashkët i projekteve investuese;
- Shfrytëzimi i mundësive për partneritete publiko-private dhe zgjerimi i këtyre shërbimeve edhe në sektorin privat dhe sektorin e shoqatave qytetare; kjo sjell dobi nga aspekti i zhvillimit rajonal proporcional për ç'gjë duhet qasje rajonale për planifikim, programim dhe hartim projektesh dhe realizimi i tyre; integrimi në BE dhe shfrytëzimi i instrumenteve paraaderuese (IPA), duke pasur parasysh faktin se preferohen partneritete dhe projekte me vëllim më të madh financimi, dhe për këtë shkak komunat e vogla duhet të bashkëpunojnë.

V.3. Përfitimet nga themelimi dhe funksionimi i bashkëpunimit ndërkomunal

Motivi për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal kryesisht buron nga nevoja për kursimin e resurseve komunale, optimizimin e kapaciteteve të të punësuarve (shfrytëzimi i plotë i kuadrove ose kompensimi nga mungesa e kuadrove të caktuar), zvogëlimin e shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për mirëmbajtje, rritjen e përqindjes së pagesës për të hyrat komunale, menaxhimin më të mirë të kompetencave të decentralizuara, shfrytëzimin më të mirë të pajisjeve dhe aftësive e të tjera. Këtu është me rëndësi të theksohet se cilësia e përmirësuar e shërbimeve ose rritja e vëllimit të shërbimeve nuk matet çdoherë me kënaqësinë e qytetarëve. Deri më tani forca lëvizëse e bashkëpunimit ndërkomunal në vendin tonë kanë qenë faktorët në vijim:

- Vëllimi ekonomik – shërbime më cilësore, por më të lira për qytetarët;
- Domsdoshmëria për një bashkëpunim të tillë për shkak të mungesës së kapaciteteve në disa komuna shumë të vogla dhe rurale në disa sfera të kompetencave, në radhë të parë pagimi i të hyrave, kontrolli inspektues, revizioni i brendshëm; dhe
- Nevoja për të siguruar zhvillim lokal më të shpejtë dhe më cilësor.

Si rezultat i kësaj, çështja për bashkëpunimin ndërkomunal shihet si mënyrë plotësuese e sigurimit të shërbimeve efikase dhe efektive, sidomos prej komunave më të vogla dhe kryesisht rurale, pa rrezikuar kështu kushtet themelore mbi të cilat është themeluar njëësia e vetëqeverisjes lokale. Ky është argumenti kyç që vërteton rëndësinë thelbësore të bashkëpunimit të komunave në kushte të vetëqeverisjes lokale njënivele dhe decentralizimit monotipik. Kjo është arsye shtesë edhe për pushtetin qendror që të sigurojë kushte ligjore, kuadri, teknike dhe financiare sa më optimale, për zhvillimin e punës së njëësive të vetëqeverisjes lokale pa kurrfarë pengesash.

V.4 Përvojat e deritanishme nga bashkëpunimi ndërkomunal në vend

Përvoja e deritanishme me formimin dhe funksionimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal në vendin tonë vërteton se potencialet në këtë sferë nuk janë të shfrytëzuara mjaftueshëm. Pushteti qendror dhe komunat në të ardhmen duhet të inkuadrohen në mënyrë më aktive për përkrahjen e iniciativave për të thelluar bashkëpunimin ndërkomunal, si formë e rëndësishme për të siguruar shërbime më cilësore komunale. Rrjedhimisht, duhet të mendohet për ndërmarrjen e hapave në vijim:

- Nevoja për hartimin e politikave për sendërtimin e vetëdijes së përbashkët, për përfitimet nga bashkëpunimi ndërkomunal;
- Promovimi më i madh i përfitimeve nga bashkëpunimi ndërkomunal;
- Ndihma administrative dhe teknike për komunat që duan të formojnë struktura të bashkëpunimit ndërkomunal;
- Vendosja e kontakteve mes komunave të cilat tanimë kanë iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal, me qëllim të marrjes së përkrahjes praktike dhe udhëzimeve për formimin dhe funksionimin e këtyre iniciativave;
- Pushteti qendror t'i tejkalojë pengesat financiare dhe operative për të cilat alarmojnë komunat, e në radhë të parë të mundësojë shpërndarje më objektive dhe më transparente të dotacioneve kapitale mbi baza të kriterëve të qarta, duke stimuluar kështu bashkëpunimin mes komunave për zhvillimin e infrastrukturës rajonale, në suaza të të gjitha kompetencave të decentralizuara.

Parashtrohet nevoja që financat nga programi për zhvillim rajonal proporcional, të shërbejnë për të zvogëluar dallimet në zhvillim mes njëësive të caktuara të vetëqeverisjes lokale, si rezultat i mosekzistimit të enteve

lokale në sferën e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, kulturës, sportit e rekreacionit dhe mbrojtjes nga zjarri, e me atë edhe nevoja për thellimin e bashkëpunimit mes komunave për formimin dhe administrimin e enteve të përbashkëta, nëse ajo nënkupton shkallë më të lartë të përmbushjes së nevojave në nivel lokal, me çmim më të ulët të shërbimeve.

Numri i madh i kompetencave të decentralizuara që kanë komunat kërkon qasje të koordinuar mes komunave fqinje, si dhe mes komunave, shtetit, organizatave ndërkombëtare dhe sektorit privat. Për të luftuar papunësinë, ndoshta do të nevojitet bashkëpunim me institucionet arsimore të komunës fqinje. Komunave duhet t'u mundësohet të sendërtojnë partneritete pikësëpari sipas nevojave dhe prioritetëve të tyre. Identifikimi i problemeve të përbashkëta dhe hartimi i politikave të përbashkëta për zgjidhjen e tyre, vetvetiu hap perspektiva për bashkëpunimin e njësisive të vetëqeverisjes lokale në të ardhmen. Përfitimet ekonomike shpesh shihen si elementi themelor i bashkëpunimit ndërkomunal. Nëse nuk ka përfitime ekonomike, komunat do të duhej ta rivlerësonin bashkëpunimin dhe, nëse është e nevojshme, resurset t'i përdornin në mënyrë tjetër.

Identifikimi i problemeve të përbashkëta dhe hartimi i politikave të përbashkëta për zgjidhjen e tyre, vetvetiu hap perspektiva për bashkëpunimin e njësisive të vetëqeverisjes lokale në të ardhmen

Në vendin tonë deri më tani kemi më shumë shembuj praktikë të bashkëpunimit ndërkomunal të suksesshëm, si më poshtë:

- Në sferën e planifikimit urbanistik-hapësinor: komuna e Vrapçishtit me komunën e Gostivarit, komuna e Bërvenicës me komunën e Bogovinës, komuna e Bogdancit me komunën e Dojranit dhe Vallandovës, komuna e Novacit me komunën e Makedonski Brodit, komuna e Rosomanit me komunën e Kavadarcit, komuna e Konçes me komunën e Radovishit, komuna e Vasilevës me komunën e Novo Sellos dhe Bosillovës etj.
- Në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor: komuna e Vrapçishtit me komunën e Gostivarit, komuna e Gostivarit me komunën e Mavrovë-Rostushes, komuna e Qendrës së Zhupës me komunën Mavrovë-Rostushe dhe komunën e Makedonski Brodit, komuna e Novacit me komunën e Mogillës, komuna e Dollnenit me komunën e Krivogashtanit etj.

- Në sferën e revizionit të brendshëm: komuna e Probishtipit me komunën e Kratovës, komuna e Sveti Nikoles me komunën e Petrovecit, komuna e Çashkës me komunën e Gradskos, komuna e Dellçevës me komunën e Pehçevës, komuna e Demir Hisarit me komunën e Resnjës, komuna e Makedonski Brodit me komunën e Mogillës, Novacit, Dollnenit, Qendrës së Zhupës, Vevçanit; komuna e Sopishtes me komunën e Kisella Vodës etj.
- Në sferën e kontrollit inspektues: komuna e Gjevgjelisë me komunën e Dojranit, komuna e Mogillës me komunën e Novacit, komuna e Vevçanit me komunën e Makedonski Brodit, komuna e Zelenikovës me komunën e Petrovecit dhe komunën e Kisella Vodës etj.

Ka edhe iniciativa tjera për bashkëpunim ndërkomunal në vend, si në sferën e zhvillimit ekonomik lokal, transportin publik të udhëtarëve, trajtimin e mbeturinave komunale/deponive rajonale, mbrojtjen nga zjarri, efikasitetin energjetik, administrimin e tatimeve dhe taksave, mbrojtjen sociale e të tjera. Prezantimi i përbashkët i dy ose më shumë komunave para donatorëve ndërkombëtarë jep shansa edhe më të mëdha për miratimin e projekteve të caktuara ose granteve. Bashkëpunimi ndërkomunal ofron mundësi të mëdha në të gjitha sferat e jetës shoqërore, duhet të punohet për të dhe të zhvillohet vazhdimisht.

VI. KOMISIONET PËR MARRËDHËNIET MES BASHKËSIVE

VI.1. Përbërja etnike e popullsisë në njësitë e vetëqeverisjes lokale

Ekzistimi i komisioneve funksionale për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive (KMB) ka të bëjë me pjesëmarrjen si parim i funksionimit demokratik, me përfshirjen e përfaqësuesve të bashkësive të ndryshme etnike në vend, për realizimin e të drejtave dhe nevojave të po atyre bashkësive etnike.

Sipas regjistrimit të fundit në vitin 2002, bashkësia etnike maqedonase numëron gjithsej 1,297,981 ose 64.18% nga numri i përgjithshëm i popullsisë, bashkësia etnike shqiptare 25.17% nga numri i përgjithshëm i popullsisë, bashkësia etnike turke 3.85%, bashkësia etnike rome 2.66%, bashkësia etnike vllahe 0.48%, bashkësia etnike serbe 1.78%, bashkësia etnike boshnjake 0.84% dhe bashkësitë tjera më të vogla etnike 1.04% nga numri i përgjithshëm i popullsisë.

Thuajse nuk ka njësi të vetëqeverisjes lokale me përbërje të pastër etnike. Gjetja e mekanizmave për përfshirjen efikase të përfaqësuesve të bashkësive të ndryshme etnike në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal është sfidë akoma më e madhe. Një nga mënyrat që i parasheh ligji është përmes formimit të komisioneve për marrëdhënie ndërmjet bashkësive.

Pse formohen komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive?

Formimi i komisionit për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive (KMB) është paraparë me dispozitat e ligjit për vetëqeverisjen lokale, si organ i veçantë dhe i përhershëm në përbërje të Këshillit Komunal dhe është mekanizëm institucional për dialog mes bashkësive në nivel lokal.

Përmes funksionimit të KMB-së, bashkësi të ndryshme etnike u mundësohet i ashtuquajtur i model i demokracisë përfaqësuese, pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre me përfaqësues në Këshillin e Komunës.

Formimi i KMB-së është i detyrueshëm në komuna ku më shumë se 20% e popullsisë së saj janë të përkatësisë së një bashkësie joshumicë. Pra, formimi i KMB-së është i detyrueshëm për gjithsej 19 komuna në vend dhe në Qytetin e Shkupit⁴. Për komunat ku numri i përfaqësuesve të bashkësi etnike joshumicë është nën 20%, ligji nuk i detyron të formojnë KMB-në. Por, duke i parë përfitimet e mundshme që mund t'i ketë komuna dhe popullsia lokale nga funksionimi i KMB-së, një pjesë e komunave vendosin t'i formojnë dhe t'i përkrahin ato. Për shembull, në komunë e Konçes, Sarajit, Studeniçanit dhe Gostivarit janë formuar KMB. Kjo është impuls pozitiv dhe vullnet i shprehur qartë për respektimin sa më të madh të të drejtave dhe nevojave të bashkësi joshumicë në ato komuna.

Përmes funksionimit të KMB-së, bashkësi të ndryshme etnike u mundësohet i ashtuquajtur i model i demokracisë përfaqësuese

Kushtetuta e vendit tonë si bashkësi të veçanta etnike në vend njeherë maqedonasit, shqiptarët, turqit, vllëhtë, romët, serbët dhe boshnjakët⁵ Përcaktimi se cilat komunitete do të përfaqësohen në KMB është sfida të vërtetë, sepse në secilën komunë ekziston përqindje më e madhe ose më e vogël e popullsisë me përkatësi të ndryshme etnike. Prandaj rekomandohet që në statutin e komunës të përcaktohet se cilat bashkësi etnike do të përfaqësohen në KMB. Qëllimet dhe përfitimet themelore nga ekzistimi i KMB-së janë siç vijon:

- Mundëson pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve të bashkësi të ndryshme etnike në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal;
- Është preventivë e hershme e problemeve potenciale me karakter etnik;
- Problemet ekzistuese me karakter etnik zgjidhen në mënyrë më efektive;
- Atyjepen propozime për avancimin e marrëdhënieve mes bashkësi të ndryshme etnike që janë të pranueshme për vetë anëtarët e bashkësi;

4 Bërvenicë, Dibër, Dollnen, Zelenikovë, Jegunovcë, Kërçovë, Krushevë, Kumanovë, Mavrovë dhe Rostushe, Petrovec, Sopishte, Strugë, Tetovë, Çashkë, Çuqer Sandevë, Qyteti i Shkupit, Butel, Çair, Shuto Orizare.

5 <https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/UstavnaRmizmeni.pdf>

- Shpalosen nevojat e popullsisë me përkatësi të ndryshme etnike, pavarësisht nga numri i bashkësisë etnike;
- Ndhmon punën e Këshillit Komunal në sjelljen e vendimeve me të cilat pajtohen pjesa më e madhe e popullsisë së bashkësive të ndryshme etnike të komunës.

VI.2. Mënyra e formimit të komisioneve për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive

Nga praktika e deritanishme në vend, ekzistojnë disa mënyra të mundshme për zgjedhjen e anëtarëve të KMB-së:⁶

- Konkursi publik për kandidimin e kandidatëve, të cilin e shpall komuna;
- Emërimi i anëtarëve/anëtareve të KMB-së nga komisioni komunal për zgjedhje dhe emërimë, pas konsultave paraprake me palët relevante (individë dhe asociacione të qytetarëve të bashkësive që janë aktive në territorin e komunës përkatëse); procedura duhet të kryhet në mënyrë transparente dhe sipas procedurës së shkruar në komunë;
- Në takime me qytetarët me përfaqësues nga bashkësitë përkatëse, të organizuara nga komuna;
- Me propozim të kryetarit/kryetares, i dhënë Këshillit në shqyrtim dhe votim;
- Përmes anketimit të qytetarëve dhe qytetareve nga ana e komunës, për të marrë propozime për anëtarë të KMB-së.

Është e nevojshme që secila bashkësi etnike të jetë e përfaqësuar me numër të barabartë të përfaqësuesve/përfaqësueseve në KMB.

Preferohet që anëtarët e KMB-së të jenë përfaqësues/përfaqësuese eminentë/e të bashkësive, të cilët gëzojnë respekt dhe llogariten si individë me integritet personal. Ata duhet të jenë persona që kanë pasur suksese dhe arritje të caktuara në lëmin e tyre profesional dhe janë autoritete në bashkësitë e tyre lokale.

A mund dhe a duhet anëtarët/anëtares të Këshillit Komunal të jenë edhe anëtarë të KMB-së?

Te ne nuk ekziston praktikë e unifikuar lidhur me këtë çështje. Te disa KMB anëtarë janë persona që në të njëjtën kohë janë anëtarë/anëtares të

⁶ BNJVL "Udhërrëfyes praktik për punën e komisioneve për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive" 2009.

Këshillit Komunal. Në raste të caktuara kjo tregohet si e dobishme parë nga aspekti i lehtësimit të komunikimit, duke qenë më i lartë edhe niveli i “lobimit” për propozimet dhe rekomandimet e dhëna nga KMB-ja në seancat e Këshillit.

Mendimet dhe propozimet nga KMB-ja duhet t’i dorëzohen me shkrim Këshillit të Komunës, përmes arkivit të komunës. Këshilli i Komunës nuk ka detyrë t’i pranojë propozimet dhe rekomandimet e dorëzuara nga KMB-ja, por ka detyrë t’i shqyrtojë dhe me procesverbal të argumentojë pranimin apo refuzimin e tyre. Lajmërimi zyrtar për rezultatin e propozimeve të shqyrtuara nga KMB-ja duhet të dorëzohet te KMB-ja.

VI.3. Funksionimi i komisioneve për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive

Për punën e KMB-së duhet të miratohet rregullore e punës së tij. Aty duhet të saktësohen aspektet themelore lidhur me sigurimin e parakushteve për funksionimin pa pengesa të komisioneve:

- Rregullat e punës së KMB-së
- Mënyra e konstituimit të KMB-së
- Procedura për zgjedhjen e kryetarit/kryetares të KMNB-së
- Caktimi i seancave të KMB-së
- Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve dhe anëtareve të KMB-së
- Në cilën gjuhë do të udhëhiqen seancat
- Mbajtja e procesverbalit nga seancat e KMB-së
- Të tjera.

Sigurimi i përkrahjes për punën e komisioneve për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive

Parakusht shumë i rëndësishëm për funksionimin e KMNB-së është sigurimi i bazës financiare në kuadër të planit financiar/buxhetit të komunës. Domethënë, që të përkrahet funksionimi i KMNB-së jo vetëm deklarativisht, preferohet që komunat të parashohin një shumë të caktuar në buxhetin e tyre vjetor. Përkrahja financiare për punën e KMB-së është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e rrugës të anëtarëve të KMB-së dhe për pjesën logjistike gjatë takimeve të punës të KMB-së. Përveç kësaj, komuna duhet të planifikojë edhe hapësira për takimet e KMB-së

dhe përkrahjen administrative për mbajtjen e takimeve, si dhe hartimin e propozimeve dhe kërkesave që në fazën e ardhshme duhet t'i dorëzohen për shqyrtim Këshillit Komunal. Është në interes të komunës dhe pushtetit komunal të investojnë në funksionimin efikas të KMB-së. Ky organ mund të kontribuojë për një nivel më të lartë të demokracisë dhe pjesëmarrjes në hartimin e politikave në nivel lokal dhe në miratimin e vendimeve lokale nga njëra anë, e nga ana tjetër, të veprojë si instrument që në kohën e duhur do të bëjë vërejtje dhe do të parandalojë konfliktet etnike.

Në komunë mund të themelohen forma të vetëqeverisjes lokale, si në vijim: në qytete – bashkësi urbane dhe në vendbanime tjera – bashkësi lokale

VII. FORMAT E VETËQEVERISJES LOKALE

Ekzistimi i bashkësive funksionale lokale dhe urbane si formë themelore e bashkësive vetëqeverisëse në vend lidhet ngushtë me vendosjen e parimit demokratik të inkluzivitetit, përkatësisht pjesëmarrjes.

Ligji për vetëqeverisjen lokale parasheh mundësinë që bashkësitë urbane dhe lokale, si qelizë parësore e vetëqeverisjes lokale, të kryejnë aktivitete të caktuara, të cilat do t'upërcillen/delegohen nga komuna dhe kryetari/kryetarja. Praktika e deritanishme ka treguar se ekziston lidhje pozitive mes ekzistimit të vetëqeverisjes lokale aktive me nivel më të lartë pjesëmarrjeje në zgjidhjen e çështjeve lokale dhe ekzistimit të besimit më të madh në vetëqeverisjen lokale, si dhe disiplinë më e madhe për pagimin e detyrimeve lokale nga qytetarët dhe qytetaret. Banorët në një bashkësi lokale duan të shohin reagim të shpejtë dhe cilësor të pushtetit lokal në zgjidhjen e problemeve lokale. Prandaj ata janë të gatshëm të kontribuojnë përmes bashkësive lokale të tyre, për përmirësimin e kushteve të jetesës, ndërsa komuna dhe përfaqësuesit e zgjedhur kanë detyrë t'i motivojnë qytetarët dhe qytetaret për një shkallë më të lartë pjesëmarrjeje në marrjen e vendimeve lokale.

Në vitin 2016 Misioni i OSBE-së në Shkup organizoi sondazh në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në vend. Përgjigjet nxorën në pah se koncepti i pjesëmarrjes qytetare në jetën politike nuk është shumë i pranishëm në vendin tonë. Ka vetëm pak përvojë për pjesëmarrjen qytetare dhe vetëqeverisjen lokale të decentralizuar në bashkësitë urbane dhe lokale.

VII.1. Statusi juridik dhe format e vetëqeverisjes lokale

Ligji për vetëqeverisjen lokale parasheh themelimin e formave të vetëqeverisjes lokale në vend. Sipas këtij ligji, në komunë mund të themelohen forma të vetëqeverisjes lokale, si në vijim: në qytete – bashkësi urbane dhe në vendbanime tjera – bashkësi lokale. Nëkohësisht, me statutin e komunës duhet të përcaktohen edhe:

- format e vetëqeverisjes lokale, që themelohen në territorin e komunës;
- marrëdhëniet me organet e komunës;

- kompetencat e kryetarit/kryetares, të cilat mund t'i delegohen kryetarit/kryetares të/së këshillit të vetëqeverisjes lokale;
- mënyra e sigurimit të financave për punët e deleguara; dhe
- çështjet e tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Banorët e bashkësive urbane dhe lokale, gjatë takimeve me qytetarët dhe qytetaret mund të shqyrtojnë çështje, të parashtrojnë qëndrime dhe të hartojnë propozime për çështje të rëndësishme për jetën dhe punën e përditshme në atë zonë. Po ashtu mund të zgjedhin edhe këshill të bashkësisë urbane, pra të bashkësisë lokale, në mënyrë dhe procedurë të paraparë me statutin e komunës. Këshilli i bashkësisë urbane ose i bashkësisë lokale zgjidhet në takim me qytetarët dhe qytetaret. Këshilli i bashkësisë urbane, pra i bashkësisë lokale nga anëtarët/anëtares e vet/a zgjedh kryetar/kryetare me mandat katërvjeçar.

Kryetarit/kryetares të këshillit të bashkësisë urbane ose lokale kryetari/kryetarja i/e komunës mund t'i delegojë kryerjen e punëve të caktuara me interes të drejtpërdrejtë e të përditshëm për jetën dhe punën e banorëve dhe banoreve, siç e parasheh statuti. Me vendimin për delegim përcaktohen edhe financat që komuna nga buxheti komunal që komuna do t'i ndajë për kryerjen e punëve dhe mënyrën e mbikëqyrjes së realizimit të këtyre detyrave.

VII.2. Themelimi dhe parakushtet për funksionimin e bashkësive vetëqeverisëse

Duhet të theksohet se, pavarësisht se me fillimin e procesit të decentralizimit u shfuqizua statusi juridik i bashkësive lokale si subjekte juridike, nuk duhet të anashkalohej rëndësia e madhe që kanë ato si qelizë parësore të demokracisë lokale. Përvoja e deritanishme tregon se një numër i madh komunash kanë sukses në sigurimin e kushteve për funksionimin e suksesshëm të bashkësive urbane dhe atyre lokale. Nga llogaria komunale rregullisht mund të transferohen para për financimin e punëve të caktuara në bashkësinë vetëqeverisëse. Këto para transferohen në nënllogari komunale për secilën bashkësi urbane/lokale dhe përmes tyre mundësohet financimi i aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme.

Që të përcaktohen rregulla transparente dhe të qarta për funksionimin e bashkësive urbane dhe atyre lokale, Këshilli i Komunës duhet të miratojë rregulla për funksionimin e bashkësive lokale⁷. Rekomandohet që rregullat të përkufizojnë këto aspekte të punës së bashkësive lokale:

⁷ BNJVL: Propozim-rregulla për punën e bashkësive lokale, 2006

- Dispozitat e përgjithshme
- Punën nën kompetencat e bashkësive lokale
- Organizimin e bashkësive lokale
- Mbështetjen e punës së bashkësisë lokale
- Bashkëpunimim mes bashkësive lokale
- Financimin
- Informimin e qytetarëve dhe qytetareve të bashkësive lokale

Bashkësitë lokale dhe ato urbane i kryejnë punët nën kompetencat e veta me mbështetjen profesionale, teknike dhe materiale të komunës. Përkrahja profesionale që sigurohet nga sektorët dhe njësitet përkatëse të administratës komunale, nënkupton hartim planesh, projektsh dhe materialesh të tjera me të cilat bashkësive lokale u mundësohet zgjidhje më e lehtë e çështjeve në interes të qytetarëve e qytetareve dhe problemeve prioritare nga sferat e ndryshme në territorin e bashkësisë së tyre lokale. Përmes shërbimeve profesionale në administratën komunale, kryetari/kryetarja duhet të ofrojë përkrahje teknike, duke siguruar materiale, shumimin ose përpunimin e tyre, si dhe përdorimin e pajisjeve teknike për prezantim dhe komunikim. Përfaqësuesve/përfaqësueseve të bashkësive lokale dhe urbane duhet t'u sigurohen edhe hapësira pune dhe pajisje, kompensime për detyrimet komunale dhe mjete materiale për furnizimin e materialeve të punës.

Në suaza të kompetencave që kanë dhe për kryerje me sukses të mandatit të vet, anëtarët dhe anëtarët e këshillave komunalë mund të kyçen në mënyrë më aktive në komunikim dhe të zhvillojnë bashkëpunimin me bashkësitë lokale dhe urbane. Disa nga mënyrat e propozuara janë:

- Lajmërimet në hapësirat e bashkësive lokale/urbane për kohën e mbajtjes së seancave të Këshillit dhe rendin e ditës;
- Informimi i qytetarëve dhe qytetareve për vendimet e marra në seancat e Këshillit;
- Takimi dhe shkëmbimi i ideve me qytetarët dhe qytetaret e një bashkësie lokale/urbane;
- Informatat kthyesë për përgjigjet pozitive apo negative lidhur me idetë e propozuara të qytetarëve dhe qytetareve;
- Organizimi i anketave për mbledhjen e informatave për opinionet e qytetarëve dhe qytetareve për çështje të caktuara me rëndësi lokale; e të tjera.

VIII. BARAZIA GJINORE NË NIVEL LOKAL

Barazia gjinore dhe të bërit politikë gjinore të përgjegjshme janë ndër elementet kyçe të qeverisjes demokratike dhe të domosdoshme për zhvillimin stabil dhe të sigurt të shoqërisë. Barazia gjinore nënkupton se në shoqëri, bashkësi ose organizatë ekzistojnë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë për përparimin kulturor, politik, ekonomik dhe social, si dhe të kenë mundësi të barabarta t'i gëzojnë të gjitha përfitimet nga progresi i shoqërisë. Pse flasim për barazi gjinore?

Çështjet për barazi gjinore nuk janë çështje femërore. Ato janë çështje që kërkojnë angazhimin dhe përfshirje të barabartë të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave

Kur flitet për barazi gjinore, është me rëndësi të dihet se ka dallim të qartë mes termeve seks dhe gjini.

- Seksi është përmbledhje e karakteristikave biologjike, siç janë ato gjinore, gjenet dhe hormonet, që e definojnë njeriun si mashkull apo femër. Seksi është koncept biologjik.
- Gjinia përcaktohet nga perceptimi i jashtëm dhe përvojat se ç'domethënë maskulinitet e çka feminitet, si dhe kuptimi shoqëror për sjellje që mund të konsiderohen mashkullore apo femërore. Gjinia është koncept social që u përcakton role të ndryshme meshkujve dhe femrave; ajo formohet dhe mësohet gjatë jetës. Për atë shkak gjinia është e ndryshueshme në kontekst kohor, varësisht nga faktorët kulturologjikë, socialë, ekonomikë, religjiozë, historikë dhe shumë të tjerë.

Role që tradicionalisht gjatë historisë u janë përshkruar grave, pa marrë parasysh se a kanë të bëjnë me familjen, shtëpinë, punën, angazhimin ose statusin shoqëror, arsimimin ose të ngjashme, kanë sjellë pabarazi mes grave dhe burrave, përkatësisht rol të varur të femrave në raport me meshkujt.

Si rrjedhojë, në pjesën e dytë të shekullit XX është shtruar nevoja që çështja për barazi gjinore të jetë në fokusin e organizatave më të larta ndërkombëtare. Më vonë kjo rezulton me udhëzime dhe rekomandime për përfshirjen e perspektivës gjinore në kornizën juridike dhe në krijimin e politikave në të gjitha nivelet. Pavarësisht nga këto përpjekje, arritja e barazisë mes grave dhe burrave në realitet është qëllim i largët edhe në shtetet e zhvilluara.

VIII.1. Korniza juridike për barazinë gjinore

Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, të njohura në të drejtën ndërkombëtare, janë vlera themelore të rregullimit tonë kushtetues. Parimi themelor i barazisë, përkatësisht mosdiskriminimi është i garantuar në Kushtetutë. Barazia gjinore është e rregulluar me ligj edhe me dispozita të tjera ligjore si dhe me marrëveshje ndërkombëtare që janë pjesë përbërëse e kornizës sonë juridike.

Në ligjin për mundësi të barabarta të burrave dhe grave, në mënyrë gjithëpërfshirëse trajtohet çështja e barazisë gjinore dhe mbrojtja nga diskriminimi në bazë seksi dhe gjinie. Më tej kjo çështje trajtohet edhe në ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe në disa ligje të tjera nga sfera e legjislacionit penal, familjar dhe i punës, që ndalojnë diskriminimin në segmente të caktuara dhe përcaktojnë promovimin e parimit të barazisë.

Njëkohësisht, si anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), në vitin 1994 vendi ynë ratifikoi Konventën e OKB-së për eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), e cila në fakt paraqet Kartën e të Drejtave të Grave.

Ligji për mundësi të barabarta të burrave dhe grave parasheh miratimin dhe realizimin e një strategjie për barazinë gjinore. Në këtë moment në fuqi janë strategjia për barazinë gjinore për periudhën 2013-2020 dhe plani kombëtar për barazinë gjinore 2018-2020. Komunitat janë të përfaqësuara në të dyja dokumentet, në suaza të prioriteteve dhe aktiviteteve strategjike të parapara.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është po ashtu i përfshirë në kornizën ligjore, por strategjia e fundit e miratuar për buxhetim gjinor të përgjegjshëm është për periudhën 2012-2017. Sipas Kodit Zgjedhor, në listën e dorëzuar të kandidatëve për deputetë/deputete dhe për anëtarë/anëtare të këshillave të komunave dhe Qytetit të Shkupit, së paku 40% e kandidatëve/kandidateve janë të gjinisë të përfaqësuar më pak dhe në çdo

pozicion të tretë, të paktën një vend i takon gjinisë të përfaqësuar më pak; më tej, të paktën edhe nga një vend në çdo dhjetë vende të parapara.

Në nivel lokal, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale-BNJVL ka miratuar Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në nivel lokal⁸ të Këshillit të Komunave dhe Rajoneve Evropiane (CEMR), të cilën pastaj ua rekomandoi komunave për implementim në dokumentet statutare lokale.

VIII.2. Përfshirja e perspektivës gjinore (gender mainstreaming) në punën e njësive të vetëqeverisjes lokale

Përfshirja e perspektivës gjinore në punën e njësive të vetëqeverisjes lokale nënkupton:

- trajtimin e barabartë të grave dhe burrave, përkatësisht mungesën e diskriminimit në bazë seksi dhe gjinie në të gjitha segmentet e veprimit të komunës;
- qasjen e barabartë në burimet dhe përfitimet eventuale, si dhe në shërbimet që i jep komuna;
- përfshirjen e barabartë në hartimin, miratimin, realizimin, ndjekjen dhe vlerësimin e vendimeve në nivel lokal;
- marrjen parasysh të interesave, nevojave dhe prioriteteve të të dyja gjinive në mënyrë të barabartë, gjatë definimit, miratimit, realizimit, ndjekjes dhe evaluimit të politikave dhe buxheteve të komunave (politika gjinore të përgjegjshme);
- marrjen parasysh të ndikimeve të ndryshme që kanë vendimet dhe aktivitetet e miratuara dhe të realizuara mbi burrat dhe gratë.

Sipas ligjit për mundësi të barabarta të burrave dhe grave, komunat kanë detyrim:

- të hartojnë plane vjetore ku do t'i përcaktojnë masat e përgjithshme dhe të posaçme për avancimin e barazisë gjinore në territorin e komunës dhe në suaza të kompetencave të NJVL-së;
- të përfshijnë parimin e barazisë gjinore në planet dhe buxhetet e tyre strategjike;
- të ndjekin efektet dhe ndikimin e programeve të tyre mbi/ gratë dhe burrat dhe të raportojnë brenda raporteve të tyre vjetore;

⁸ Këshilli i Komunave dhe Rajoneve Evropiane: Karta evropiane për barazinë e grave dhe burrave në jetën lokale, 2006.

- të marrin pjesë në përgatitjen dhe realizimin e strategjisë për barazi gjinore në pjesën që ka të bëjë me njësitë e vetëqeverisjes lokale;
- gjatë miratimit të planeve, akteve dhe vendimeve zhvillimore, Këshilli dhe organet e tjera të NJVL-së janë të detyruar t'i shqyrtojnë dhe t'i marrin parasysh masat dhe aktivitetet e propozuara nga Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe koordinatori për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.

Mekanizmat gjinorë në nivel lokal në kuadër të institucioneve përbëhen nga strukturat në vijim: komisionet për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe koordinatorët për mundësi të barabarta të grave dhe burrave. Këshilli i Komunës ka detyrë që me vendim të formojë Komisionin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave si organ i përhershëm. Komisioni punon në kuadër të Këshillit dhe përbëhet nga këshilltarë me mandat katërvjeçar. Përbërja, kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit përcaktohen me statutin e komunës. Sipas ligjit për mundësi të barabarta, komisioni është i detyruar:

- të japë mendim lidhur me materialet dhe propozimet për seancat e Këshillit;
- të marrë pjesë në hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike, buxhetit, statutit, programit për punën e Këshillit etj.
- të identifikojë dhe të japë propozime për mënyrat e inkorporimit dhe formalizimit të parimit për mundësi të barabarta dhe për mosdiskriminim në punën e organeve të komunës dhe administratës komunale;
- të kujdeset për realizimin e përpiktë të dispozitave të ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe ligjeve të tjera nga sfera e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit;
- në bazë të analizave paraprake, t'i propozojë Këshillit masa dhe aktivitete për avancimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, lidhur me gjendjen në sferat që janë nën kompetencat e komunave.

Përveç komisionit, komunat kanë detyrë të caktojnë edhe koordinatorin/koordinatoren dhe zëvendëskoordinatorin/en për mundësi të barabarta të Grave dhe burrave nga radhët e zyrtarëve/zyratereve shtetëror/e brenda njësisë të vetëqeverisjes lokale. Në segmentin e detyrave të punës të përfshira në ligjin për mundësi të barabarta dhe në aktin për sistematizimin e vendeve të punës të njësisë të vetëqeverisjes lokale, koordinatori/koordinatorja dhe zëvendëskoordinatori/ja duhet të bashkëpunojnë me komisionin për mundësi të barabarta, duke qenë kanali lidhës mes NJVL-së

dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, e cila ka kompetenca për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit për mundësi të barabarta, e njëkohësisht edhe realizimin e strategjisë për barazinë gjinore. Koordinator/koordinatorja për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, së paku një herë në vit, më së voni deri më 31 mars të vitit aktual, ka detyrë që Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, për vitin paraprak t'i dorëzojë raport dhe ta publikojë atë në faqen e internetit të komunës. Në rast se Këshilli nuk emëron komision për mundësi të barabarta ose komuna nuk emëron koordinator/koordinatorë për mundësi të barabarta apo raporti nuk dorëzohet në kohë në Ministri, ligji për mundësi të barabarta parasheh sanksione kundërvajtëse.

VIII.3. Mekanizma dhe masa për avancimin barazisë gjinore në nivel lokal

Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm për avancimin e barazisë gjinore. Ata mund të jenë të fokusuar brendapërbrenda (përmirësimi i barazisë gjinore në komunë, përfaqësimi i balancuar i burrave dhe grave dhe përforcimi i kapaciteteve të brendshme të komunës) dhe të drejtuara nga jashtë (përmirësimi i barazisë gjinore në territorin e komunës dhe në suaza të kompetencave të komunës). Pa marrë parasysh se cilat mekanizma zbatohen, është e domosdoshme që personat të cilët merren me këtë çështje dhe që janë të kyçur në këto procese, të kenë mirëkuptim të plotë dhe të jenë të sensibilizuar për çështjet gjinore. Më poshtë janë dhënë disa nga mekanizmat dhe masat që ka në dispozicion komuna për avancimin e barazisë gjinore:

- Rritja e vetëdijes së përfaqësuesve/përfaqësueseve të zgjedhur/a dhe administratës, për termat dhe konceptet themelore për realizimin e barazisë gjinore;
- Trajnime të specializuara për përfaqësuesit/përfaqësueset e zgjedhur/a dhe administratën, për avancimin e barazisë gjinore;
- Masa për përfaqësimin e balancuar të burrave dhe grave në të gjitha segmentet dhe në të gjitha nivelet e komunës;
- Kryerja e analizës gjinore ose analiza e barazisë gjinore në një sferë të caktuar, është mekanizëm që jep informacione për aspektet e ndryshme që burojnë nga diversiteti i sekseve dhe gjinive. Kjo analizë ndihmon të kuptohen modelet e ndryshme të pjesëmarrjes, sjelljes dhe përfshirjes së grave dhe burrave, si dhe implikimet përkatëse që burojnë nga këto sjellje në sferat e ndryshme të jetës shoqërore. Analiza tregon barazinë ose jobarazinë mes burrave dhe grave në raport me qasjen të resurset. Analiza gjinore mund t'i hulumtojë

edhe shkaqet për pabarazinë e tillë dhe të japë udhëzime për hapat e mëtutjeshëm që do të sjellin ndryshim pozitiv. Analiza gjinore e bërë pas intervenimeve të caktuara, pas ndonjë vendimi të marrë ose politike të miratuar, do të japë informata për ndikimet e ndryshme dhe efektet që ka pasur mbi gratë dhe burrat.

- Që të përgatitet çfarëdo analize gjinore, është e nevojshme të ketë statistikë të ndarë gjinore. Për këtë arsye nevojitet që komunat, në suaza të mundësive të veta, të mbajnë statistikë gjinore të ndarë për të gjitha veprimtaritë që bëjnë.
- Planifikimi – përpilimi i planeve të specializuara strategjike lokale dhe/ose planeve të aksionit dhe/ose programeve për barazi gjinore. Në bazë të analizës gjinore të bërë më herët në sfera të caktuara, definohet strategjia e intervenimit dhe në përputhje me të edhe plani i aksionit, me masa dhe tregues konkretë të përcaktuar për ndjekjen dhe matjen e rezultatit të arritur. Për realizimin e planit është shumë e rëndësishme të caktohet dhe të miratohet buxhet përkatës, në rast të kundërt do të jetë i vështirë realizimi i tij.
- Zbatimi i buxhetimit gjinor të përgjegjshëm gjatë hartimit të politikave dhe programeve – buxhetimi gjinor i përgjegjshëm është proces gjatë të cilit rishikohen buxhetet publike me qëllim që të vlerësohet se si menaxhohen resurset publike nga aspekti i barazisë gjinore. Kjo nuk do të thotë përpilim i buxheteve të veçanta për gra, por vlerësim i buxheteve nga aspekti i barazisë gjinore dhe përfshirje e perspektivave gjinore në të gjitha nivelet në proceset e buxhetimit.
- Zbatimi i masave afirmative – miratimi dhe zbatimi i masave të veçanta dhe të përkohshme për inkurajimin e gjinisë të përfaqësuar më pak dhe përshpejtimi i realizimit të barazisë.
- Shkëmbimi i praktikave pozitive në rajon dhe vendet e BE-së nga aspekti i ligjeve dhe politikave gjinore të ndjeshme;
- Përfshirja e perspektivës gjinore në statutet e njësive të vetëqeverisjes lokale;
- Përfshirja e aspektit gjinor në furnizimet dhe investimet publike etj.

Rekomandim

Vlen të theksohet se çështjet për barazi gjinore nuk janë çështje femërore. Ato janë çështje që kërkojnë angazhimin dhe përfshirje të barabartë të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave. Këto janë çështje që i prekin të gjithë.

IX. ETIKA DHE INTEGRITETI NË NIVEL LOKAL

Këshilli i Komunës duhet të miratojë kodeksin etik për anëtarët dhe anëtarët e Këshillit.

Ç'përfaqëson etika?

Ajo merret me parimet morale sipas të cilave sillet një person i caktuar gjatë kryerjes së një aktiviteti. Teoria e etikës përqendrohet te mënyra si përcaktohen vlerat morale, ç'është ajo që i definon veprimet si të drejta apo të gabuara. Rrjedhimisht, etika nënkupton përcaktimin se cila pjesë e popullatës ose grup i caktuar konsideron se diçka është e drejtë apo e gabuar.

Çfarë është integriteti?

Integriteti ka të bëjë me cilësinë e sinqeritetit dhe sjelljes së një personi sipas parimeve dhe PRINCIPEVE të fuqishme morale. Integriteti është zgjedhje personale e një personi që t'i përmbahet me përpikëri standardeve të caktuara morale. Në etikë integriteti konsiderohet si sinqeritet dhe vërtetësi ose precizitet i veprimit të dikujt.

"Integriteti është ajo që bëni kur askush nuk shikon.", K.S. Luis, shkrimtar dhe teolog britanik.

IX.1. Korniza ligjore për modelin e integritetit të përfaqësuesve dhe përfaqësuesve të zgjedhur/a

Modeli i integritetit është një problematikë shumë komplekse që prek pjesën më të ndjeshme të shoqërisë. Përfaqësuesit e zgjedhur të pushtetit lokal u nënshtrohen sfidave të ndryshme gjatë kryerjes së funksionit të tyre, e për atë qëllim janë miratuar një varg ligjesh dhe rregulloresh që i japin drejtim dhe definojnë punën e tyre.⁹ Me ligj

9 Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, 2002

parashihen masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit gjatë qeverisjes, autorizimet publike, detyrat zyrtare dhe politika, masat dhe aktivitetet për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit gjatë kryerjes së punëve me interes publik të subjekteve juridike, e që janë në lidhje me ushtrimin e kompetencave publike.

Personi i zgjedhur ose i emëruar, personi përgjegjës në ndonjë ndërmarrje publike, ent publik ose subjekt tjetër juridik që ka kapital shtetëror, gjatë zgjedhjes ose emërimit, në afat prej 30 ditëve nga dita e zgjedhjes ose emërimit, plotëson fletën anketuese me evidencë të detaluar për pronën e patundshme, pasuritë e tundshme me vlerë të madhe, letrat me vlerë dhe arkëtimet dhe detyrimet, si dhe për pasuri të tjera që janë pronë e tij/saj apo pronë e anëtarëve të familjes së tij/saj, duke cekur origjinën e pronës së paraqitur dhe duke deponuar një deklaratë të noterizuar se heq dorë nga mbrojtja e sekretit bankar sa u përket të gjitha llogarive në bankat vendore dhe të jashtme.

Deponimi i kësaj deklarate është detyrë individuale. Po ai person ka detyrë të plotësojë fletën anketuese në afat prej 30 ditëve pas përfundimit të mandatit, që organet kompetente të kryejnë kontrollin e rritjes përkatëse të pronës së personit sipas të ardhurave ligjore që ka realizuar ai/ajo në periudhën e kryerjes së funksionit. Fleta anketuese dhe deklaratat i dorëzohen Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike.

Konflikte interesi të anëtarëve/anëtareve të Këshillit të Komunës:

1. Anëtari/anëtarja i/e Këshillit nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje që ai/ajo ose partneri i tij/saj, fëmija ose ndonjë farefis deri në brezin e dytë ka interes financiar ose interes tjetër personal.
2. Anëtari/anëtarja i/e Këshillit është i/e detyruar ta informojë Këshillin për çështjet për të cilat ai/ajo ka interes financiar apo interes tjetër.
3. Anëtari/anëtarja i/e Këshillit nuk mund të jetë i/e punësuar në administratën komunale në komunën ku është zgjedhur.
4. Ditën që anëtari/anëtarja i/e Këshillit punësohet në administratën komunale, merret se ai/ajo ka dhënë dorëheqje nga Këshilli.
5. Anëtari/anëtarja i/e Këshillit i/e punësuar në shërbimet publike që ka themeluar komuna nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje që kanë të bëjnë me shërbimin publik ku është i/e punësuar.

Anëtarët dhe anëtares e Këshillit duhet të demonstrojnë patjetër nivel të lartë integriteti personal dhe kolektiv në kryerjen e funksionit të vet. Me sjelljen e tyre etike duhet të jenë organ që do të kontribuojë për parandalimin e veprimeve korruptive edhe tek organet tjera të komunës – kryetarët/kryetares dhe të punësuarit në administratat komunale.

Modeli i integritetit është pjesë përbërëse e sistemit të udhëheqjes së mirë dhe kontribuon për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Kur bëhet fjalë për qeverisjen e mirë, në thelb mendohet për sendërtimin dhe kultivimin e frymës së integritetit në nivel personal dhe institucional, me çka do të nxi tej dhe do të sigurohej pavarësi, profesionalitet dhe llogaridhënie në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera. Anëtarët dhe anëtares e këshillave duhet të kuptojnë se integriteti domethënë “rezistencë ndaj korrupsionit”, ndërsa sistemi për integritet nënkupton përmbledhjen e të gjitha politikave, standardeve dhe procedurave të implementuara në organin për administrim–Këshillin e Komunës, të cilat përforcojnë rezistencën e tyre nga korrupsioni dhe zvogëlojnë rrezikun për sjelljen korruptive të përfaqësuesve dhe përfaqësueseve të zgjedhur/a.

Në nivel personal, integriteti do të thotë zotërim njohurish dhe aftësish por edhe kapacitet personal etik, vendosmëri dhe profesionalizëm i secilit anëtar/anëtare të Këshillit, për të respektuar rregulla dhe praktika të vendosura, për të punuar gjithmonë në dobi të interesit publik, për shmangur konfliktin potencial të interesit dhe për të mos kontribuar për krijimin e rrethanave negative dhe të dëmshme në bashkësinë lokale.

IX.2. Mënyrat për përforcimin e integritetit të funksionarëve lokalë

Politikat për zhvillimin e komunës duhet t’u dedikohen tërësisht qytetarëve dhe qytetareve për realizimin e papenguar të të drejtave të tyre, për ballafaqimin e fuqishëm dhe të vendosur kundrejt korrupsionit dhe saksionimit e sjelljes joetike eventuale. Te liderët/lideret e zgjedhur/a lokalë/e nuk duhet të tolerohet sjellja korruptive, përkatësisht keqpërdorimi i funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare dhe pozitës, për të realizuar çfarëdo dobie për anëtarin/anëtaren e Këshillit ose për ndonjë person të afërt të tij/saj. Po ashtu, në këshillat komunalë nuk duhet të tolerohet çfarëdo forme tjetër e sjelljes joetike dhe jomorale, të ndaluar me ligj dhe në kundërshtim me kodin etik të sjelljeve. Që të përforcohet integriteti në suaza të punës së organeve komunale, rekomandohet që të zbatohen aktivitetet në vijim:

Miratimi i politikave të qarta dhe atyre antikorruprive në dispozicion

Secila komunë duhet të miratojë aktin për politikë antikorruprive që do të shpallet publikisht, ashtu që secili funksionar/funksionare ta dijë ku gjendet ai akt dhe si të arrijë tek ai. Politika antikorruprive duhet të jetë e qartë dhe koncize dhe t'i reflektojë vendimet politike. Është shumë me rëndësi që anëtarët/anëtares e Këshillit të kenë kopje të politikës së miratuar antikorruprive që nga fillimi i mandatit të tyre.

Vendosje e standardeve dhe procedurave për parandalimin e korrupsionit në sfera të caktuara

Është me rëndësi që standardet të zhvillohen në proces inkluziv, që të gjithë liderët/lideret e zgjedhur/a të jenë të kyçur/a në mënyrë aktive në proces.

- Standardet dhe politikat mund të përfshihen në kodin etik të komunës. Ato mund të shpallen edhe si politika, procedura dhe standarde të veçanta. Ato standarde dhe procedura duhet patjetër t'i kenë elementet në vijim: dhuratat, mikpritja, udhëtimet.
- Ofrimi i mitës. Si duhet të veprojnë personat të cilëve iu ofrohet ryshfet?
- Shantazhet dhe kërcënimet nga jashtë. Si t'iu kundërvihen dhe si të veprojnë këta persona?
- Presioni politik. Si t'i kundërvihet anëtari i Këshillit, si, ku dhe te kush ta denoncojë sjelljen joetike?

Metodologjia për vlerësimin e rrezikut

Është me rëndësi të ketë metodologji për vlerësimin e rrezikut, që do të shërbejë për identifikimin e tij dhe ballafaqimin me mundësitë e shfaqjes së këtyre sjelljeve në Këshillin e Komunës. Këto aspekte mund të përfshihen edhe në strategjinë e përgjithshme për menaxhimin e rreziqeve dhe rreziqeve nga korrupsioni në nivel lokal. Në këtë mënyrë do të parandalohet fenomeni i veprimeve korruptive.

Trajnimi

Përmes programeve për trajnim mund të kontribuohet për rritjen e vetëdijes të liderët/lideret e zgjedhur/a për rreziqet konkrete dhe për mënyrat e shmangies dhe zvogëlimit të rrezikut nga korrupsioni. Vetë anëtarët dhe anëtarët e Këshillit duhet të kërkojnë trajnime të cilat do të përqëndrohen te përvetësimi i politikave efektive për luftën kundër korrupsionit.

Kanalet e brendshme për denoncuesit dhe mbrojtja e denoncuesve të korrupsionit

Në komunë duhet të miratohen udhëzime për denoncimin përmes internetit të korrupsionit potencial dhe zyrtari përgjegjës me të cilin mund të bisedohet për çështjen. Këshillat e etikës t'i japë person nga komuna, si për shembull zyrtari përgjegjës për denoncimin e korrupsionit. Revizioni i brendshëm në institucionin përkatës duhet të jetë i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për përputhshjen/sistemet e integritetit, veçanërisht në raport me zbatimin e metodologjisë për vlerësimin e rrezikut. Të gjitha organet e komunës duhet të vënë kontakt dhe t'i përdorin udhëzimet për parandalimin e korrupsionit të shërbimeve përgjegjëse në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, si institucion kompetent në vendin tonë i cili përgjigjet para Parlamentit.

Komisioni për vlerësimin e sjelljes etike

Për të nxitur sjelljen etike në komunë, Këshilli mund të inicojë formimin e komisionit për vlerësimin e sjelljes etike dhe respektimin e standardeve etike nga të gjitha organet e komunës. Ky komision mund të jetë i ngarkuar për dorëzimin e raporteve periodike në Këshill dhe të miratojë përfundimet për veprim në periudhën që vijon.

Që të promovohet sjellja etike në nivel lokal, anëtari/anëtarja e Këshillit, pas pranimit të detyrës, duhet të marrë përgjegjësi edhe më të madhe për sjelljen e tij/saj në jetën publike dhe private, e në rast konflikti interesash, të mbajë përgjegjësi personale për rrethanat ku identifikohen sjellje të tilla. Publiku ka të drejtë t'i dijë informacionet që janë me interes publik dhe t'i mundësohet qasje e lehtë tek ato. Po ashtu, Këshilli mund të kërkojë trajnime plotësuese nga persona kompetentë në Sekretariatit e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, për të nxitur sjelljen etike dhe përforcimin e integritetit.

Sjellja etike dhe morale e anëtarëve të Këshillit duhet të kultivohet dhe të shpërblehet bashkë me qytetarët dhe qytetaret, duke insistuar te kontaktet më të shpeshta dhe të drejtpërdrejta. Duhet të punohet në mënyrë aktive dhe në vazhdimësi për rritjen e mirëbesimit mes anëtarëve dhe anëtareve të Këshillit dhe çdoherë të nxiten aktivitete që çojnë drejt zgjidhjes efikase të problemeve të qytetarëve. Këshilltarët dhe këshilltaret, pa dallim përkatësie politike kanë detyrë të sillen në mënyrë etike dhe t'i promovojnë vlerat morale në mjedisin ku jetojnë e jashtë tij, sepse kryejnë funksion publik. Është etike:

- të merren vendime që janë në interes të qytetarëve dhe qytetareve;
- vendimet të sillen në interes të pjesës më të madhe të qytetarëve dhe qytetareve, e jo në interes të individëve;
- të tejkalohet interesi i ngushtë partiak;
- të merren vendime që janë në dobi të shumicës së qytetarëve dhe qytetareve, pavarësisht cilin opion politik kanë përkrahur ose po përkrahin ende;
- një anëtar/anëtare i/e Këshillit të votojë për një zgjidhje të caktuar, të propozuar nga oponenti politik në Këshill.

Rekomandime

Kompensimi financiar për praninë në seancat e Këshillit nuk duhet të jetë motivi i vetëm për angazhim më të madh në Këshill. Shpeshherë pikërisht për shkak se seancat e komisioneve të Këshillit nuk paguhen, anëtarët dhe anëtalet mund të mos tregojnë konstruktivitet dhe të mos japin kontribut në punën e komisioneve. Por, edhe në qoftë se marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutimet në Këshill, këshilltarët/këshilltaret nuk duhet të tregojnë interes vetëm gjatë mbajtjes së komisioneve dhe seancave të Këshillit. Prej tyre si përfaqësues e përfaqësuese lokal/e, lider e lidere të zgjedhur/a, kërkohet angazhim i përditshëm dhe vetiniciativë.

Jeta private e anëtarëve/anëtareve të zgjedhur të Këshillit dhe familjes më të ngushtë të tij/saj janë në vazhdimësi objekt observimi i qytetarëve dhe qytetareve, përkatësisht votuesve. Anëtarët/anëtalet e Këshillit duhet të jenë të pranishëm në të gjitha ngjarjet në komunë pa dallim tematike, ku do të mund të realizojnë takime të drejtpërdrejta me qytetarët dhe qytetaret. Secili funksionar/funksionare i/e zgjedhur, përkatësisht anëtar/anëtare Këshilli duhet ta përshtasë kohën e vet të lirë dhe angazhimin profesional me funksionin që kryen.

LITERATURA PLOTËSUESE

1. Misioni i OSBE-së në Shkup: Raport për procesin e decentralizimit 2006-2011, Shkup, 2011
2. Dushica Perishiq dhe të tjerë: Doracak për kryetarët dhe këshilltarët e komunave për kompetencat e vetëqeverisjes lokale, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, Shkup, 2017
3. Dejan Donev, Irena Nikolov, Cezari Trutkovski: Drejt një komune transparente, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, Shkup, 2008
4. Kodi etik i funksionarëve të zgjedhur, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, Shkup, (mund të gjendet në këtë link: http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/Izdanija/Publikacii/MK/20Eticki_Code_MKD.pdf)
5. Projekti i IPA-s "Përkrahje për parandalimin dhe luftën efikase kundër korrupsionit": Menaxhimi i konflikteve të interesit - udhërrëfyes, Shkup, 2016 (mund të gjendet në këtë link: <http://www.dksk.org.mk/images/Priracnici/3%20priracnik.pdf>)
6. Doracak për integritetin dhe konfliktin e interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Shkup, 2013 (mund të gjendet në këtë link: https://www.dksk.mk/fileadmin/user_upload/priracnik_za_integritet.pdf)
7. Rregulla pune të bashkësive lokale, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, Shkup, 2006 (mund të gjendet në këtë link: http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/Izdanija/Publikacii/MK/24Pravila_MZ_MKD.doc)
8. Misioni i OSBE-së në Shkup: Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike, Shkup, 2012 (mund të gjendet në këtë link: <https://www.osce.org/mk/skopje/104549>)
9. Joana Kosma, Kristina Jovanova: Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen në nivel lokal, Misioni i OSBE-së në Shkup, Shkup, 2013 (mund të gjendet në këtë link: <https://www.osce.org/mk/mission-to-skopje/231361?download=true>)
10. German Fillkov, Sabina Fakiq, Marko Mitevski: Indeksi i transparencës aktive 2017, Qendra për Komunikim Qytetar, Shkup, 2017 (mund të gjendet në këtë link: <http://civicamobilias.mk/wp-content/uploads/2018/03/ia2017m.pdf>)
11. Georgi Hristov, Jane Vërteski, Natasha Ilijeva-Acevska, Armine Vërteska: Zëri i qytetarëve – Hulumtim i kënaqësisë së qytetarëve nga shërbimet komunale, Fondacioni Shoqëria e Hapur, Shkup 2012 (mund të gjendet në këtë link: <http://soros.org.mk/dokumenti/glasot-na-graganite-mk.pdf>)
12. Strategjia për mbrojtjen nga korrupsioni në komunat Gjorçe Petrov, Manastir dhe Ohër, Fondacioni Shoqëria e Hapur, Shkup, 2008 (mund të gjendet në këtë link: <http://fosm.mk/CMS/Files/Documents/antikorupciski-strategii-mak-za-web.pdf>)

BURIME JURIDIKE TË PËRDORURA

1. Ligji për e vetëqeverisjen lokale, Gazeta Zyrtare nr.5/2002
2. Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, Gazeta Zyrtare nr.61/2004
3. Ligji për organizimin territorial të njësive të vetëqeverisjes lokale, Gazeta Zyrtare nr.55/2004
4. Ligji për qytetin e Shkupit, Gazeta Zyrtare nr.55/2004
5. Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal, Gazeta Zyrtare nr.79/2009
6. Ligji për mbikëqyrjen inspektuese, Gazeta Zyrtare nr.50/2010
7. Ligji për Inspektoratin Shtetëror për Vetëqeverisjen, Gazeta Zyrtare nr.158/2010
8. Ligji për zhvillimin rajonal të barabartë, Gazeta Zyrtare nr.63/2007
9. Ligji për kontrollin e brendshëm financiar publik, Gazeta Zyrtare nr.90/2009
10. Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, Gazeta Zyrtare nr.28/2002
11. Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, Gazeta Zyrtare nr.6/2012
12. Ligji për planifikimin hapësinor dhe urban, Gazeta Zyrtare nr.199/2014
13. Ligji për ndërtimin, Gazeta Zyrtare nr.130/2009
14. Ligji për veprimtaritë komunale, Gazeta Zyrtare nr.95/2012
15. Ligji për zjarrfikjen, Gazeta Zyrtare nr.67/2004
16. Ligji për procedurën e përgjithshme administrative, Gazeta Zyrtare nr.124/2015
17. Ligji për kulturën, Gazeta Zyrtare nr.31/1998
18. Kodi Zgjedhor, Gazeta Zyrtare nr.40/2006

